



MEKANIZIMI:
MBROJTJA KUR PUNONI ME TRAKTOR

REVISTË PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



BUJQ, NE E USHQEJMË BOTËN



**Cilësia dhe
rendimenti
stabil i specit të
kuq – ajvarit**



**Pemëtar i ri dhe i
suksesshëm me
traditë familjare**



**Mos e ndizni
kashtën
Është e dëmshme!
Është e rrezikshme!
Është e ndaluar!**



**Si ta mbrojmë
bletën autoktone
mjaltëdhënëse
magedonase**



**ZBATIMI I DREJTË DHE
EFIKAS I UJITJES**

6

**HIGJIENA E
QUMËSHTIT**



12



**UJITJA SOLARE I
ZVOGËLON SHPENZIMET
AFATGJATA NË BUJQËSI**

16

**PREZANTIMI I
MUNDËSIVE TË
DRONËVE
NË BUJQËSI**



17



**NDIKIMI I KRIZËS AKTUALE
MBI ÇMIMIN E KOSTOS SË
PRODHIMEVE BUJQËSORE**

21



**FEDERATA NACIONAL
E FERMERËVE**

FEDERATA NACIONAL E FERMERËVE

Adresa: rr. Prolet, nr. 10/1-1, 1000 Shkup
Tel: +389 70 216 109
e-mail: nff@nff.org.mk
webfaqe: www.nff.org.mk



AGROPUKA

Adresa: Lagjia e Re, Pukë
Tel.: +355 212 2 2412. Mob.: +355 68 23 88 169/
+35569 57 42 060/ +35567 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
webfaqe: www.agropuka.org



AGRINET ALBANIA

Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
webfaqe: www.agrinet.al



WeEffect – Qendra Suedeze për Kooperativa, punon me organizatat partnere në mbi 20 vende, me vizion të botës së qëndrueshme dhe të drejtë të çliruar nga varfëria. WeEffect e mbështet revistën rajonale "Toka Ime" me qëllim që të zhvillohet lëvizja e bujqve në Ballkan dhe të përforcohet zëri i përbashkët i bujqve.

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FNF, AGRINET, AGROPUKA për Shqipërinë, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit në suazat e sektorit bujqësor.



**FEDERATA NACIONAL
E FERMERËVE**

Toka ime, Tetor 2022

Botues: FNF

Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Prolet, nr. 10/1-1,
1000 Shkup
e-mail: nff@nff.org.mk
Udhëheqës: Stevan Orozovic

**Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:**
Biljana
Petrovska-Mitrevska
Botuar më:
Tetor 2022

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska

Bashkëpunëtorë profesionale:
Nikolin Karapançi, Tomi Pikuli, Sabah Djaloshi,
Elinarda Kolgjokaj, Prof.dr. Aleksandra Martinovska-
Stojcevska, Diplo.inz. agr. Stojan Gligorov, Prof.dr.
Vjekoslav Tanaskovikj, Prof.dr. Sonja Sbrbinovska, Prof.
dr. Dragi Tanevski i Angela Samardzijk.

Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]

EDUKIMI DHE PËRFORCIMI I LIDERËVE NË FSHATRA

Edhe pse gratë, sipas natyrës, janë të ndryshme nga burrat, ky dallim nuk i bën më pak kompetente dhe as më pak të vlefshme se burrat, por natyra grave ua plotëson dobësitë dhe përparësitë e burrave.

Kjo është kuptuar pak dhe është e gërshetuar me paragjykime dhe stereotipa, sidomos në mjediset rurale. gratë në mjediset rurale po ballafaqohen ende me mungesën e informimit, edukimit, eksploatimin e punës së tyre, vlerësimin e vogël të mundit dhe përfshirjen në vendimmarrje në familje dhe në biznes. Është e vogël përqindja edhe e grave në mjediset rurale të cilat janë pronare të tokës dhe pronës bujqësore dhe si barrierë e madhe shfaqen normat tradicionale, përkatësisht pronarë të pronës dhe tokës janë burrat.

Këto janë sfida të mëdha mbi të cilat duhet të punohet dhe para së gjithash duhet të punohet në edukimin dhe

përforcimin e aftësive liderë të grave.


Aftësia që të ndikohet është shkathtësia themelore liderë. Të ndikosh nënkupton jo vetëm kontroll por edhe metoda konkrete të cilat nevojiten që të zbatohen mbi sjellje, qëndrimet, mendimet dhe përzgjedhjen e të tjerëve. Ndikimi nuk duhet të ngatërrohet me fuqinë ose kontrollin. Në të vërtetë, bëhet fjalë për shënimin e asaj që e motivon përkushtimin e të punësuarve dhe përdorimi i kësaj në njohuri që të shfrytëzohen performancat dhe rezultatet pozitive. Aftësia e liderit që të ndikojë mbi të tjerët bazohet në besim, në të vërtetë, ndikimi do të përkufizohet si termin që zgjerohet në mënyrë proporcionale me sasinë e besimit që ekziston në një lidhje. Lideritei është mundësi që të ndërtohen norma, rregulla të caktuara dhe të hiqen stereotipat.



Me respekt,
Biljana Petrovska-Mitrevska
Redaktorja kryesore dhe
përgjegjëse e revistës "Toka ime"

**Gëzuar 15 Tetorin - Ditën
Ndërkombëtare të Gruas Rurale**

LUFTË E PËRBASHKËT KUNDËR COVID 19





Cilësia dhe rendimenti stabil i specit të kuq – ajvarit

Teknologjia e kultivimit të specit KURTOVSKA KAPIJA

Autor: Inxh. dipl. agr. Stojan Gligorov

Gjatë kultivimit të specit Kurtovska kapija si në hapësirë të hapur ashtu edhe në hapësirë të mbrojtur gjatë vegjetimit nevojiten një sërë masash me qëllim që të mundësohet zhvillim dhe rritje normale e specit. Prashitja dhe germimi i bimëve të reja kryhet pas rrënjosjes ose 15-20 ditë pas mbjelljes. Qëllimi i kësaj mase agroteknike është prashitja e shtresës së sipërme ose sipërfaqësore, mundësimi i një regjimi më të mirë të ngrohtësisë ose ajrit dhe shkatërrimi i barërave të këqija. Kjo mund të bëhet edhe me makinë, e cila madje rekomandohet për kursim të fuqisë punëtore dhe efikasitetit më të madh, por paraprakisht duhet të përcaktohen me saktësi rreshtat.

PËRZGJEDHJA E LLOJIT QË KULTIVOHET

Rekomandimi ynë është që gjatë kultivimit të Kurtovska kapisë të organizohet prodhimtari në bazë të

marrëveshjeve të lidhura paraprakisht me kapacitetet përpunuese që të kenë siguri prodhuesit në plasmanin e prodhimitarisë në të cilën do të investojnë punë dhe mund.

Varietetet më të përdorura janë: Kurtovska Kapia, Palanečko čudo, Amfora, Veshi i Elefantit. Por praktikë e rekomanduar duhet të jetë varieteti i cili do të kultivohet ta për zgjedhë dhe rekomandojë kapaciteti përpunues, në varësi të llojit të prodhimit për të cilin do të synohet, pra nëse do të jetë për tharje, për turshi, për ajvar etj.

UJITJA E SIPËRFAQEVE ME SPEC

Një nga masat gjatë kultivimit është edhe ujitja. Shumica e prodhuesve bëjnë gabime të mëdha në metodën ose përcaktimin e kohës së ujitjes. Praktika aktuale është pa analiza të ujit, të kryer paraprakisht, kurse në shumicën e rasteve ujitja bëhet me brazda dhe me sistem pikë për pikë.



Rekomandimi është nëse ka mundësi ujitja të kryhet nëpërmjet sistemit pikë për pikë, i cili ka shumë përparësi. Me ujitjen me vonësë ose të tepërt, gjendja mund të jetë më e keqe në raport me zhvillimin e bimëve që në kultivimin e mëtejshëm do të reflektohet negativisht mbi rendimentin dhe cilësinë.

Pas reshjeve të shumta në rajon janë shënuar dëme mjaft të mëdha ku disa nga bimët apo zonat ku rritet speci në ambient të hapur, janë shkatërruar plotësisht. Aty ku ujitja kryhet nëpërmjet një sistemi me pika, lagështia gjithashtu rregullohet dhe plehrat përdoren për të ushqyer. Është shumë e rëndësishme të theksohet se ujitja bëhet herët në mëngjes ose natën vonë, sepse temperaturat ditore janë shumë të larta dhe kur uji bie në kontakt me qafën e rrënjës, krijohen kushte për shfaqjen e sëmundjeve parazitare.

Zhvillimi normal i specit në Rajonin e Strumicës lidhet ngushtë me faktorin e klimës, d.m.th. dallimi midis temperaturave të larta ditore dhe temperaturave të ulëta të natës. Bima e përballon me vështirësi këtë gjë dhe ndodh rritja e çrregullt të gjethet dhe lulët dhe më vonë bimët e tilla nuk janë në gjendje të japin perime.



**PËR RENDIMENT DHE CILËSI
TË LARTË PLEHËRIMI ËSHTË
KRYESORI**

Plehërimi në praktikë zakonisht kryhet pa analizë të tokës. Plehrrat organikë zakonisht shtohen para lërmimit në vjeshtë, kurse para mbjelljes plehrrat minerale NPK dhe ushqimi me kalcium dhe kalium.

Ushqimi është një masë shumë e rëndësishme agroteknike. Nevojiten të paktën dy ushqime, kurse për një rendiment mbi 35 ton/ha nevojitet edhe një ushqim i tretë. I pari kryhet për afërsisht 20 ditë pas mbjelljes me pleh azotik p.sh. KAN, rreth 250-300 kg/ha. I dyti 20 ditë pas të parit me plehra të kombinuara NPK, me 200kg/ha KAN dhe 200kg/ha 10-30-20 ose 15-15-15. Nëse ka nevojë për një ushqim të tretë, atëherë vazhdoni si në suplementin e mëparshëm.

**MBROJTJA PARANDALUESE QË
TË MOS KETË PROBLEME ME
SËMUNDJET DHE DËMTUESIT**

Mbrojtja në shumicën e rasteve, prodhuesit e bazojnë në përvojat e kaluara ku kanë ndodhur dëme të mëdha, por kur prodhuesit kërkojnë që mbrojtja të jetë nën mbikëqyrjen e një eksperti, rezultatet janë të dukshme. Këshilltarët nga Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë së RMV (ANZHB) janë në dispozicion të prodhuesve në çdo kohë për konsultime, këshilla dhe ndihmë në zgjidhjen e disa problemeve në terren. Rekomandohet që produktet mbrojtëse të specit të përdoren kur kushtet në mjedis janë të përshtatshme për zhvillimin dhe shfaqjen e sëmundjeve dhe dëmtuesve. Për sëmundjet rekomandohet që të përdoren në tokën dhe ujin e infektuar, ndërsa për viro-



zat pas shfaqjes së bartësve të virusit (morra, cikada, thrips) është mirë të trajtohet me insekticide kontakti.

Sëmundjet më të shpeshta të specit në Rajonin e Strumicës janë shtrirja e fidanëve (Phizostoniya solani, Pythium sp.), hiri i specit (Phytophthora capsici), venitja verticiliumi (Verticillium albo-atrum), virusi i mozaikut të kastravecit (CMV) virusi i mozaikut të duhanit (TMV).

Dëmtuesit më të mëdhenj të specit janë morrat e gjetheve (Myzus persicae, Aphis gossypii), Mamestra brassicae, M.oleraceae, krahëbardhja etj.

Burimi: ANZHB

ZBATIMI I DREJTË DHE EFIKAS I UJITJES

Ujitja ndikon mbi rendimentin, cilësinë dhe fitimin

Autor: Prof. dr. Vjekosllav Tanaskoviç, Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit - Shkup

Në prodhimtarinë bujqësore në vendin tonë realizohen rendimente më të vogla sesa nga ato që mund të prodhohen realisht. Një prej shumicës së arsyeve për rezultate të tilla, si edhe për çmimin jokonkurrues në treg, është ujitja joefikase, pra aplikimi i gabuar i teknikës së ujitjes dhe përcaktimi i kohës dhe sasisë së nevojshme të ujit për ujitje. Si rrjedhim, zgjedhja e duhur e teknikës së ujitjes, përcaktimi i saktë i kohës dhe sasisë së nevojshme të ujit për ujitje janë ndoshta një nga masat më të rëndësishme për përmirësimin e rendimenteve të kulturave bujqësore, kurse nga ana tjetër dhe për përdorimin më racional të ujit në prodhimtarinë bu-

jqësore, veçanërisht kur pritet që në të ardhmen ndryshimet klimatike të kenë një ndikim më të madh në prodhimin bujqësor dhe burimet ujore në vendin tonë.

PËRCAKTIMI I NEVOJAVE PËR UJË PËR UJITJEN E KULTURAVE BUJQËSORE

Kulturat hortikulturore kanë nevojë të larta për ujë në krahasim me shumicën e kulturave bujqësore dhe vreshtave të rrushit, kurse në raste të caktuara edhe me kulturat frutore. Nevoja të tilla janë kryesisht për shkak të gjetheve të mëdha dhe të trasha të ndjeshme ndaj avullimit, si dhe për shkak të sistemit rrënjor të zhvilluar dobët me fuqi të dobët thithëse. Në përgjithësi, me shumicën e kulturave hortikulturore, momentet kritike për ujitje janë koha e prodhimit të fidanit, pastaj pas mbjelljes së kulturës në një vend të përhershëm, lulëzimi, pjekuria teknologjike dhe fiziologjike e frutave.

Tek frutat dhe vreshtat e rrushit, furnizimi me ujë është një kusht shumë i rëndësishëm për rritjen, zhvillimin dhe frytëzimin normal. Fru-

tat kanë nevojë më të mëdha për ujë në krahasim me hardhinë, në radhë të parë për shkak të masës më të madhe vegetative, ndërsa pjelloria e hardhisë ka lidhje të kundërt me cilësinë. Kërkesat për ujë nuk janë të njëjta edhe për varietetet e verës apo të rrushit të tryezës. Nevojat më të mëdha të pemëve frutore në vegetacion të plotë ndodhin që nga fillimi i lulëzimit deri në pjekjen e frutave, kur mungesa e ujit në tokë mund të ndikojë shumë negativisht, veçanërisht mbi sasinë dhe cilësinë e frutave, sepse formohen më shumë lulet me defekte, ndodh fekondimi jo i plotë, frutat e rrudhura kanë formë të çrregullt, rënie më intensive e frutave, gjë që përfundimisht rezulton në një ulje të rendimentit përfundimtar. Në rastin e specieve frutore me bimësi më të hershme, sigurimi i ujit pas vjeljes së frutave mundëson ruajtjen e kulturës, përkatësisht krijimin e përshtatshmërisë dhe kushteve për vegetacion të duhur në vjeshtë, dimër dhe pranverë.

Ujitja e vreshtit në vegetacion të plotë ka ndikim pozitiv mbi zhvillimin dhe prodhimin e tij. Sigurimi optimal me ujë mundëson që vreshti ta marrë aktivisht ujin dhe materiet



ushqyese nga trualli, zhvillim më të shpejtë të rrënjës, zhvillim më të mirë të vegjetacionit mbitokësor, zmadhim të rezistencës kundër sëmundjeve dhe temperaturave të ulëta, rendiment më të lartë dhe më të mirë. Në rastin e hardhisë, nevojat më të mëdha për ujë shfaqet nga fundi i lulëzimit, në fazën e formimit të kokrrave, deri në 20-25 ditë para vjeljes.

Kulturat e fushës kanë karakteristika të ndryshme biologjike, prandaj edhe regjimi i tyre i ujitjeve është i ndryshëm. Në vendin tonë, drithërat e trashë kultivohen shpesh pa ujitje, për këtë arsye rendimentet janë shumë të ulëta dhe në kushte ujitje rendimenti rritet deri në 300%. Misri, panxhari i sheqerit, orizi, jonxha shquhen si konsumatorët më të mëdhenj të ujit nga kulturat e arave.

PËRCAKTIMI I DREJTË, NË KOHË DHE EFIKAS I UJITJES SË KULTURAVE BUJQËSORE

Ujitja në kohë dhe efikase është ajo ujitje ku sasia e duhur e ujit aplikohet në momentin e duhur për kulturën. Çdo devijim mund të ndikojë negativisht mbi rendimentin dhe cilësinë e kulturave bujqësore, çmimin e produktit, si dhe mund të ndikojë negativisht në mjedis. Padyshim që ujitja me sasi më të vogël e më të madhe uji është po aq i dëmshëm për kulturat bujqësore.

Praktika e deritanishme në vendin tonë dëshmon për shumë pak aplikim të ndonjë metode për përcaktimin e kohës dhe sasisë së ujit për ujitje, madje edhe nëse përdoren, ato kryesisht aplikohen pjesërisht.



BURIMI I ZGJIDHJES OPTIMALE TË TEKNIKAVE TË UJITJES

Në shtetin tonë rreth 60% e sistemeve të ujitjes ndërtohen për zbatim të teknikave nën presion, kurse rreth 40% ndërtohen për aplikim të teknikave gravitacionale të ujitjes dhe sisteme për shpëlarje të orizit.

Në varësi nga teknika e zbatuar, efikasiteti lëviz nga nën 50% te teknikat gravitacionale të ujitjes, rreth 75% te shiu artificial, deri në 95% te ujitja pikë për pikë. Nëse nuk mund të zbatohet një teknikë më efikase, nevojitet të merren masa për përcaktimin e parametrave optimalë për ujitje me teknikën e ujitjes në dispozicion, në mënyrë që të arrihet efikasiteti sa më i lartë i përdorimit të ujit. Përzgjedhja e zgjidhjes optimale për ujitje varet nga shumë parametra (burimi i ujit, madhësia dhe topografia e parcelës, vetitë e tokës, kultura, teknikat e aplikuara bujqësore, parametrat ekonomikë, etj.). Në vendin tonë aplikohen të gjitha teknikat e ujitjes, por praktikohet më së shumti ujitja me brazdë, përmbytja, shiu artificial dhe mikroujitja.

MIKROUJITJA

Mikroujitja është masa kryesore agroteknike për arritjen e rendimenteve të qëndrueshme dhe cilësore nga kulturat bujqësore, kurse është veçanërisht i rëndësishëm për rajonet ku ka mungesë uji. Edhe në vendet me reshje mesatare vjetore më të larta, pra ku ujitja nuk është e detyrueshme, përdoret mikroujitja për të aplikuar pleh organik nëpërmjet sistemit (fertigation). Studimet e shumta sot tregojnë se investimet e bëra në këtë teknikë janë të justifikuar që në vitin e parë, si rezultat i rendimentit më të lartë dhe i cilësisë më të mirë të prodhimit.



Pemëtar i ri dhe i suksesshëm me traditë familjare

Kajsia është me leverdi nëse kultivohet profesionalisht. Ky vit është fantastik për ne dhe kemi prodhim prej 50 tonë për hektar dhe mendoj se kajsia është kulmi në pemëtari.

Goce Angellov nga Gradsko është një bujk i ri i suksesshëm i cili sukseset e tij në agrobiznes i bazon në traditën familjare të përkushtuar ndaj pemëtarisë prej 30 vjetësh. Në familjen e tij janë kultivuar gjithmonë të mbjella frutash dhe në to vendin kryesor dhe dominues e ka zënë kajsia, ndonëse kanë edhe pjeshkat, të njohura për atë rajon. Pika nga e cila nis çdo gjë për mirë është momenti kur vendosin të marrin një kodër, afër Gradskos, me koncesion nga shteti, e cila prej vitesh ishte jo tërheqëse dhe e papunuar. Dhe ndërsa të gjithë i shikonin të habitur, sesi vendosën të konkurrojnë dhe t'i paguajnë qira shtetit çdo vit për kodrën që askush nuk e donte, ata përsëri për vendin kishin një qasje pak më ndryshe, të informuar nga përvoja e tyre e mëparshme në kultivimin e kajsisë. Ky lokacion është arsyeja që ne si familje, së bashku me përvojën që kemi, kemi qenë të suksesshëm për shumë vite në frutikulturë. Vendndodhja në vetvete është 220 deri në 250 metra mbi nivelin e detit dhe është larg rrjedhave të lumenjve Cërna dhe Vardar, si dhe është larg nga rajonet malore përreth. Në këtë mënyrë, vendndodhja siguron që ne të jemi larg masave të ftohta ajrore që në fillim të pranverës kur kajsia



lulëzon ose kur porsa ka filluar të zërë frutë.

Ngricat e pranverës si një fenomen negativ janë një nga faktorët kryesorë për atë se si do të jetë procesi i prodhimit. Fatkeqësisht, të gjithë e ndjemë fuqinë e tyre shkatërruese në lëkurën tonë vitin e kaluar, kur për një periudhë treditore, nga data 6 deri më 8 prill, temperatura ra në -9 gradë celsius dhe për këtë arsye nuk mbeti asgjë nga prodhimi që të vilet. Në një vit të tillë as vendndodhja ime nuk u kursye nga dëmet e mëdha, por na ka ndodhur një herë në punën tonë të deritanishme që të kemi humbje të tilla. Për dallim

nga ai vit, të gjitha vitet e tjera, duke përfshirë këtë vit 2022, kam një prodhim të shkëlqyer edhe pse këtë vit në pranverë pati përsëri ngrica dhe një pjesë e madhe e pemishteve me kajsia dhe pjeshkë u ngrinë dhe u formuan komisione për vlerësimin e dëmeve.

Në kushtet kur temperaturat e ulëta janë jetëshkurtra dhe kur nuk hyjnë thellë në minus, pemishtja ime nuk pëson asnjë dëm, sepse masat e ftohta të ajrit, duke qenë më të rënda, shkojnë gjithmonë në luginat dhe grykat përgjatë lumenjve dhe atje dëmi është gjithmonë më i madh. Ky vit është fantastik për ne dhe kemi një kulturë prej 50 tonësh për hektar, që mendoj se është kulmi në frutikulturën për kajsia, tha Goce Angellov, një pemëtar i ri nga Gradsko.

MASAT AGROTEKNIKE JANË FAKTOR SHUMË I RËNDËSISHËM PËR CILËSINË DHE RENDIMENTIN

Përveç përzgjedhjes së lokacionit të lokacionit, i cili është domethënës dhe që në shfrytëzimin e deritanishëm nuk na ka lënë nën 20 tonë për hektar, dhe kemi pasur një vit me 60 tonë për hektar kur janë thyer degët e kulturës dhe kur kemi kemi vjelë rreth 200 tonë





Gjithashtu, një hallkë e rëndësishme për prodhimin e kajsisë cilësore është edhe mbrojtja që ky frutidhënës i ri realizon me sukses në bashkëpunim me proteksionistët ekspertë me të cilët punon prej vitesh, por edhe duke testuar pjesërisht çdo gjë të re në një pjesë të prodhimit, kurse vetëm pastaj aplikim në të gjithë plantacionin në vitet në vijim, sepse jo gjithçka që shkruhet dhe deklarohet në preparate mund të funksionojë në çdo mikrolokacion dhe në kushte të ndryshme.

USHQIMI PO KËRKOHEM DHE DO TË KËRKOHEM GJITHNJË EDHE MË SHUMË, KURSE CILËSIA DO TË KETË GJITHMONË ÇMIM TË MIRË



Tashmë me vite ky pemëtar i ri nuk ka probleme me plasmanin. Për cilësinë e mirë jo vetëm që ka gjithmonë plasman por arrihen edhe çmime të mira.

- Këtë vit jemi të kënaqur me çmimin e kajsisë. Sezoni ynë filloi me çmimin e blerjes prej 60 denarë për kilogram, kurse gjatë gjithë blerjes u stabilizua në 40 denarë, që është mjaft e kënaqshme për ne dhe besojmë se së shpejti do të vijë koha kur ushqimi që është gjithnjë e më pak i disponueshëm, të kërkohet dhe do të kërkohet. Do të na mbetet vetëm të organizohemi, të kapërcëjmë siç e dimë problemet me prodhimin dhe me fuqinë punëtore, e cila është gjithnjë e më pak dhe të prodhojmë, kurse rezultatet do të vijnë vetë në fund. Në periudhën nga fundi i korrikut dhe fillimi i gushtit ka përfunduar vjelja e kajsisë dhe tani është duke u vjelë nektarina e pjeshkës, e cila është në 10 hektarë dhe e cila këtë vit ka prodhuar 30 tonë për hektar, shtoi Angellov nga Gradsko.

Në muajt e dimrit, para se të fillojnë aktivitetet e rreth krasitjes së kajsive, Goce nuk pushon shumë. Gjatë asaj periudhe kontrollon i gjithë mekanizimi, lubrifikohet madje edhe riparohet sepse ai e di se kur sezoni është në kulmin e tij nuk ka shumë vend për manovra dhe në atë periudhë çdo gjë duhet të jetë në funksion dhe të punojë në mënyrë të përkryer që të mund t'u përkushtohet gjërave të tjera të rëndësishme. Kështu, në muajt e dimrit rregullohen plotësisht pompat e mëdha të naftës që kanë filtra të mëdhenj rëre dhe që duhet të kenë edhe një tepricë si rezervë, që në kulmin e sezonit të mbjellat të mos vuajnë për ujë.

kajsi, le t'i mbledhim, po aq dhe ndoshta më domethënëse janë masat agroteknike që zbatohen gjatë gjithë vitit. Vjelja nuk e përfundon aspak puna në pemishtë, sepse në atë moment fillon e gjithë puna e rëndësishme dhe përcakton se si do të jetë korrija e ardhshme e prodhimit. Në periudhën pas vjeljes deri sa ka ende një gjethe, mund të shtohen mikroelementet bor dhe zink nëpërmjet të cilët zakonisht gjenden në tokë dhe nuk nevojiten në sasi të mëdha, por lëvizin me vështirësi dhe shpesh për shkak të mungesës së tyre, ka diferencim të dobët të degëve pjellore të cilat formohen praktikisht gjatë vjeshtës. Përveç kësaj, këta dhe elementë të tjerë mikro dhe makro ushqyes janë shumë të rëndësishëm për formimin e imunitetit të degëve, që nëse ushqehen mirë do të jenë mjaft më rezistent ndaj stresit gjatë prodhimit dhe pikërisht një stres i tillë janë temperaturat e ulëta në periudhën e pranverës që kur zgjohet vegjetacioni.



cilët kopshtarinë e ka veprimtari shtesë, është fakti se pas vjeljes i harrojnë pemishtet dhe për to kujtohen në pranverë kur, sipas tyre fillon viti i ri. Jo, për ne viti prodhues fillon menjëherë pas vjeljes dhe atëherë kujdesemi që pemët ta marrin trajtimin dhe ushqimin e nevojshëm që të kemi fillim të mirë të vitit të ardhshëm. Madje edhe vjet kur nuk volem asnjë kajsi ne duhej të investonim nga rezervat tona që të investojnë te të mbjellat, njëjtë sikur të kemi marrë prodhim madje edhe më mirë që të tejkalohet stresi dhe të formohen degë të reja prodhuese që të kemi një prodhim si ky i sivjetshmi. Është mirë që një pjesë e madhe e frutikulturëve që janë profesionistë nga rajoni im e dinë ende këtë pas fatkeqësisë së vitit të kaluar që na ndodhi me ngricat, humbjen e të gjithë të vjelave, ata ia dolën akoma më mirë dhe vazhduan të investonin, gjë që shihet edhe nga prodhimtari e tyre solide këtë vit. Ajo që është gjithashtu domethënëse është se plantacioni ynë ndodhet pranë njërit prej kanaleve vaditëse të Tikveshit, kështu që merr po aq ujë sipas nevojës pa asnjë kursim, tha Angellov.

- Një nga gabimet më të shpeshta të kultivuesve të kajsive, kurse e cila shprehet theksueshëm tek ata të

Mos e ndizni kashtën

Është e dëmshme! Është e rrezikshme!

Është e ndaluar!

Humbjet e materieve ushqyese pas ndezjes së mbeturinave të kashtës shkojnë deri në 30% vetëm tek azoti, kurse ndezja e shpeshtë e kashtës çon në efekt negativ të të a.q. “truall i vdekur”



Me të dalë kombajnat e korrjes për bujqit fillojnë shumë shqetësime dhe obligime. Sa do të jenë rendimentet, ku do të shitet kokrrat dhe me çfarë çmimi, a do të ketë vend për ta ruajtur nëse çmimet e blerjes janë të ulëta, si të paguhet kombajneri dhe ku të investohet në naftë për plugimin e parë menjëherë pas korrjes, që është shumë domethënëse për të ndaluar avullimin kapilar të lagështisë në shtresat më të thella. Mbi të gjitha këto pyetje e rëndojnë fermerin, atij i duhet të zgjidhë edhe problemin e mbetjeve të korrjes. Kashta që mbetet pas korrjes në ara mjaft shpesh e mblidhet dhe përdoret, një pjesë e fermerëve të cilët janë të informuar mirë se çfarë fsheh kjo kashtë në vetvete dhe si mund të kthejë lëndët ushqyese dhe kështu të kursejë në ushqim dhe të hedhin një qese pleh më pak, kurse nëpërmjet kësaj kursehet shumë nëse merret parasysh se plehërimi nga çmimi vlen aq shumë si flori-

ri, ata e lërojnë menjëherë ose përdoren mjete që janë në bazë natyrore dhe me ndihmë të mikroorganizmave ndihmojnë në shpërbërjen e mbeturinave të korrjes dhe i shndërrojnë materiale ushqyese për të mbjellat vjeshtore.

Problemi i mbetjeve të korrjes mund të ndahet përafërsisht në dy pjesë. E para janë mbetjet e korrjes pas korrjes së elbit dhe grurit, ndërsa e dyta, e cila është problem më i madh dhe vazhdon prej dekadash, është problemi në Luginën e Koçanit pas korrjes së orizit. Pas korrjes së drithërave të vjeshtës si elbi dhe gruri, fermerët kanë kohë të mjaftueshme, dhe kushtet klimatike në verë janë të favorshme për mbledhje dhe më pas shfrytëzimin ekonomik të mbetjeve të korrjes, kurse këtu ndezja e tyre është madje e pamendueshme, pse dikush mund ta bënte, ndërsa pas korrjes së orizit, e cila zakonisht është vonë në vjeshtë, koha për dekompozimin e këtyre mbetjeve është

më pak e favorshme sepse fillon të bjerë shi dhe nuk ka kohë të mjaftueshme për të dekompozuar këto mbetje të korrjes që pengojnë lërimin.

NDEZJA E KASHTËS ËSHTË E DËMSHME

Plehrat artificiale për shkak të konfliktit ushtarak rus-ukrainas dhe për shkak të destabilizimit të tregut të gazit me të cilin punojnë kryesisht fabrikat për prodhimin e plehrave minerale me çmimin e tyre janë një pasuri e vërtetë.

Ka ardhur koha kur fermerët e varfëruar vendosin më lehtë të lihet fusha pa pleh dhe të shpresojnë për fitime minimale sesa të ndërmarrin një rrezik dhe të shpenzojnë të gjitha paratë e tyre dhe më pas të shpresojnë për çmimet e blerjes që do ta mbulojnë atë dhe ta kthejnë investimin e bërë.





Parë nga aspekti i plehrave të shtrenjta artificiale del se askush nuk do të niste të digjte mbetjet e korrjes që përmbajnë lëndë ushqyese që kthehen në tokë nëpërmjet lërimit dhe zvogëlojnë nevojën për plehra artificiale dhe ndihmojnë në formimin e pjesës së humusit në tokë në një përqindje të caktuar, kurse nëpërmjet tij dhe në pjellorinë e arave. Por edhe përkrah investimeve të mëdha dhe ankesave të vazhdueshme se plehrrat janë shtrenjtuar, ka ende një numër të madh fermerësh që vendosin më lehtë t'i djegin mbetjet e të korrave sesa t'i lërojnë ato.

- Me ndezjen e mbeturinave të korrjes humbet një pjesë e çmuar e azotit të truallit i cili është element thelbësor.

Djegia e mbetjeve të korrjes është masë e padëshirueshme nga aspekti agroteknik është. Një pjesë e madhe e masës organike shkatërrohet, e cila nëse lërohet, do të kthehet në mikroorganizma të tokës, të cilët do ta zbërthejnë atë masë organike në lëndë ushqyese që janë në dispozicion të sistemit rrënjor të bimëve në tokë, duke pasuruar kështu vetë tokën me lëndë organike. Ajo që nuk e shohim me sy gjatë djegies është ajo që është më e vlefshme dhe humbet në mënyrë të pakthyeshme, thotë profesora dr. Danica Andreevska - UKEM, Instituti Bujqësor Shkup, Stacioni i orizit në Koçan.

- Temperaturat që zhvillohen në sipërfaqen e tokës në atë shtresë prej 5 centimetrash ku ndodhen të gjithë lëndët ushqyese dhe mikroorganizmat janë



arsyeja kryesore e humbjeve të shkaktuara nga djegia e kashtës. Gjithashtu, djegia e mbetjeve të korrjes shkakton ndotje të ajrit me grimcat PM10, të cilat më së shumti thithen nga fermerët, arat e të cilëve digjen në fushat e fshatrave, si dhe familjet, fëmijët dhe nipërit e tyre. Përveç kësaj, me djegien masive të mbetjeve të arave të orizit në Koçan, po humbasin edhe disa lloje të shpendëve që ekzistojnë prej vitesh këtu, kurse problem i madh me pakësimin e ushqimit krijohet edhe për lejkëkët, të cilët janë në njëfarë mënyre markë e Luginës së Koçanit, konsideron agronomi Valentin Zahariev nga Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë nga Koçani.

NDEZJA E KASHTËS ËSHTË E RREZIKSHME

Ndezja e kashtës nga fermerët paraqet një rrezik dhe kërcënim serioz për pronat dhe jetën e banorëve përreth. Problemi kryesor është se kur e djegin kashtë për të mos u kapur duke djegur arat, fermerët ikin menjëherë nga arat duke lënë gjithçka në duart e zjarrit, por shumë shpesh ndodh që era të ndryshojë drejtimin e saj dhe madje të rritet, kurse pastaj gjërat dalin nga kontrolli. Vetëm në dy vitet e fundit, një person që po digjte kashtë vdiq në vend dhe u shkaktoi dëme të mëdha në plantacionet e vjetra, shtëpitë për vikend dhe objektet ndihmëse që u dogjën gjatë zjarrit. Njësi territoriale e zjarrfikësve nga Koçani, e cila duhet të mbrojë zonat urbane nga zjarri në komunat Koçan, Zërnovci dhe Çeshinovë – Obleshevë, gjithnjë e më shumë po i shfrytëzon resurset dhe kapacitetet e veta për shuarjen e zjarreve nëpër fusha, duke i lënë qytetet e pambrojtura. Prej këtu arsyetohen edhe deklaratat e zjarrfikësve, të cilët thonë se fermerët sillen me shumë egoizëm duke djegur arat nga të cilat kanë korrur më parë të mbjellat, kanë marrë një shpërblym në formën e subvencioneve nga shteti dhe në fund, me djegien, ato shkaktojnë një rrezik të përgjithshëm. Si shembull mbrojtja e shtëpive të një rruge të tërë në fshatin Gërdovci, kur u përfshinë dhjetë zjarrfikëse, tri prej të cilave ishin nga Vinica dhe një nga Shtipi, kurse vitin e kaluar një pompë karburanti, si dhe një impiant për trajtimin e ujërave të zeza, janë mbrojtur nga zjarri i shkakuar nga djegia e kashtës në Mojanci, i cili është një objekt kapital me vlerë 30 milionë euro.

NDEZJA E KASHTËS DËNOHET

Që të ndalet ky fenomen shkatërrues, nga i cili dëmi më i madh është në kurrizin e fermerëve që humbasin edhe më shumë, pushteti qendror ka në dispozicion disa mjete jopopullore. Paralelisht

me blerjen e subvencionuar të kombajnave të reja që kanë një pajisje për prerjen e kashtës në dalje dhe përpjekjet për të ringjallur grumbullimin e kashtës dhe bërjen e kompostos prej saj në impiantin e trajtimit, në parandalimin i djegies së kashtës mund të përfshihet edhe inspektorati rajonal, pasi sipas Ligjit të tokës dënohet djegia e mbetjeve të korrjes. Në Kroaci, kushdo që në arën e tij konstatohet se ka djegur kashtë dënohet me shkurtimin e subvencioneve.



ZGJIDHJE TË MUNDSHME PËR MBETJET E TË KORRURAVE NË RAJONIN E KOÇANIT

Në korrik të vitit 2019 në fshatin Mojanci të Koçansko u hap solemnisht stacioni i pastrimit, i cili për momentin grumbullon ujërat nga Koçani dhe në fazën e dytë do të kyçen ujërat e zeza nga Vinica. Vlera, pjesa më e madhe e së cilës është donacion nga qeveria zvicerane, është rreth 30 milionë euro në pajisje dhe teknologji të fundit për t'u shërbyer 65 mijë banorëve dhe prej saj vjen uji i pastër teknik, metani si dhe komposti i përfutur nga përzierja dhe përpunimi i mullirit të mbetjeve të marra nga stacioni së bashku me kashtën e orizit. Komposti që del i ka kaluar të gjitha analizat dhe është i një cilësie të shkëlqyer ka një përfitim të dyfishtë. Përpunohet kashta, e cila do të merrte 70 deri në 80% të mbetjeve nga Fusha e Koçanit dhe arat në vend që të digjen plehërohen përsëri. Ky synim përfundimtar i këtij objekti kapital nuk është realizuar ende plotësisht, sepse nevojitet mbështetje shtesë nga qeveria në pajisjen dhe rregullimin e marrëdhënieve dhe detyrimeve me bujqit nëpërmjet kushtëzimit në vend që të djegin kashtën ta dorëzojnë për përpunim në stacionin e pastrimit në Mojanci.

Higjiena e qumështit

**Si të arrihet
rendiment më i lartë,
çmim më i lartë blerës dhe
subvencione më të mëdha
për qumështin.**



Praktika e mirë në fermë është baza për plasman të prodhimeve të sigurta dhe cilësore të qumështit ku roli i fermerëve është kolosal. Çdo prodhues prodhues në fermën e tij duhet të sigurojë zbatimin korrekt të praktikës së mirë të fermës, praktikës së mirë higjienike dhe praktikës së mirë në blegtori. Në të ardhmen e afërt pritet aplikimi i plotë i sistemit të pagesës së qumështit sipas cilësisë, pra futja e klasave për qumështin e papërpunuar sipas numrit total të mikroorganizmave dhe qelizave somatike. Një fermer që prodhon qumësht të papërpunuar me më pak se 100,000 baktere totale dhe më pak se 400,000 qeliza somatike do të marrë një çmim më të lartë për litër qumësht të papërpunuar dhe subvencione më të mëdha.

Cilësia higjienike e qumështit të papërpunuar dhe valorizimi i tij ka një rëndësi shumëpërdoruese në industrinë e qumështit, me të cilën prodhuesit - fermerët dhe përpunuesit e qumështit realizojnë interesin e tyre ekonomik. Prodhuarit e qumështit e arrijnë këtë duke rritur prodhimin e qumështit dhe një çmim më të lartë, ndërsa përpunuesit marrin një produkt të sigurt, shfrytëzim më të madh të qumështit dhe përmirësim të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së produkteve të gatshme.

KËRKESA PËR BAGËTINË

Kafshët duhet të jenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe pa sëmundje infektive ose sëmundje të thithave. Parandaloni hyrjen e sëmundjeve në fermë. Krijoni një program efektiv të menaxhimit të shëndetit/sëmundjeve të tufës. Përdorni barna veterinare siç përshkruhet nga veterinerët. Trajtoni të gjithë njerëzit që punojnë në fermë. Çdo kafshë duhet të regjistrohet në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit. Etiketa e identifikimit në veshin e çdo kafshe përdoret për të përcaktuar origjinën e saj, por edhe për gjurmueshmërinë e produktit. Përdorni ushqim të sigurt për lopët dhe me një ushqim të ekuilibruar të duhur, prodhimi i qumështit rritet, por përforcon gjithashtu edhe sistemin imunitar të lopës.

ÇFARË DUHET TË BËJMË NËSE KAFSHË ËSHTË E INFEKTUAR OSE E SËMURË?

Çdo kafshë e sëmurë ose nëse dyshojmë se është e sëmurë, duhet ta izolojmë menjëherë nga kafshët e tjera të shëndetshme. Kafshët e sëmura milen të fundit, kurse qumështi i mjelës nuk mund të përdoret për ushqim dhe duhet hiqet.

ÇFARË DUHET TË BËJMË NË PERIUdhËN DERISA KAFSHA MERR MJEKIME, POR EDHE NJË KOHË PAS KËSAJ, PËRKATËSISHT GJATË PERIUdhËS SË KARENCËS?

Karrenca është një periudhë gjatë së cilës preparati mjekësor i aplikuar ekskretohet në qumësht, domethënë koha kur kafsha trajtohet dhe një periudhë e caktuar pas kësaj. Qumështi që përmban mbetje antibiotike nuk duhet të përzihet me qumësht tjetër dhe nuk duhet të jepet për blerje.

KËRKESA PËR FERMAT

• Objektet dhe ambientet që pastrohen dhe dezinfektohen lehtë. Pastrimi dhe dezinfektimi i stallës duhet të kryhet me ndërjegje dhe të plotë, gjë që siguron kontributin në shëndetin e lopëve dhe në përmirësimin e cilësisë së qumështit.

• Nxjerrje e rregullt jashtë e plehut nga ferma dhe nxjerrje përkatëse e ujërave të pista – të mos ketë burime kontaminimi!!!

• Ventilim dhe dritë adekuate në fermë – pa korrent. Është mirë që lagështia e ajrit të jetë midis 65 dhe 80%. Temperatura në stallë duhet të jetë nga 5-20°C, përkatësisht lopët e tolerojnë më lehtë temperaturën e ulët se sa temperaturën e lartë të ambientit, por duhet të sigurohen shtretër të thatë dhe të izoluar mirë.

• Përdorni ujë të pijshëm cilësor dhe të sigurt, vendosni një lavaman për larjen e duarve. Për ushqimin e kafshëve dhe për ruajtjen e higjienës së fermës (larja e sistemit të mjeljes, tubit të qumështit, kovave, rezervuarit të ftohjes dhe pjesës tjetër të enëve) duhet të përdoret uji i pastër higjienik.

KËRKESA PËR PROCESIN E MJELJES

Mjela mund të bëhet manualisht ose mekanikisht. Qumështi i mjelës merret nga stalla në një dhomë të veçantë ndihmëse në kova ose nëpërmjet një sistemi për sjelljen e qumështit. Mjela bëhet më së miri në mjelëse, madhësia e të cilave varet nga numri i lopëve.

MBANI MEND – Gjatë mjeljes NUK MUND: të pastrohet stalla, nuk duhet të sillet dhe shpërndahet ushqim kabast (bar i thatë) dhe kashtë dhe të rrihen lopët, nuk duhet të ndizet traktori apo makineritë e tjera që krijojnë zhurmë dhe i shqetësojnë kafshët dhe nuk lejohet hyrja e kafshëve të tjera apo hyrja e personave të panjohur në stallë.

Gjatë mjeljes, në stallë duhet të ketë sa më pak pluhur dhe mikroorganizma. Gjatë mjeljes me makineri, duhet të kemi një sistem mjeljeje të saktë (vakum dhe pulsime të sakta), i cili duhet të lahet dhe dezinfektohet mirë. Nëse mjela bëhet në mjelëse, ajo duhet të lahet mirë dhe të dezinfektohet menjëherë pas mjeljes.

REKOMANDIME PËR PROCEDURË TË RREGULLT GJATË MJELJES

1. **LARJA DHE DEZINFEKTIMI I DUARVE** - Mjelësi duhet të veshë gjithmonë rroba të pastra dhe t'i lajë mirë duart para mjeljes. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet thonjve, të cilët duhet të jenë të prerë dhe të pastër, sepse mund të dëmtojnë thithën.

2. PASTRIMI, LARJA DHE DEZINFEKTIMI I THITHËS PARA MJELJES



- heqja e papastërtive nga thitha
- dezinfektimi zgjat 30 sekonda
- fshirja e thithës me pecetë letre të veçantë

3. MJELJA E CURRILAVE TË PARA TË QUMËSHIT DHE KONTROLLI

- shfaqja e fjollave dhe kokrrizave është shenjë e mastitisit – veçohet qumështi i mjelë.
- mos milni asnjëherë mbi dyshe me ose shtresë
- me currilat e para e lani brendësinë e thithës – më pak baktere në qumësht



4. MJELJE (5-7 MIN) – QUMËSHTI DUHET TË RRJEDHË MENJËHERË PAS VENDOSJES NË NJËSINË PËR MJELJE



Gota mjelëse të vendosura si duhet



Aparat për mjelje që nuk është vendosur si duhet

5. DEZINFEKTIMI I THITHAVE PAS MJELJES



Mjet për dezinfektim



Mjet mbrojtës mekanik

PROCEDURA PAS MJELJES

Pas mjeljes, qumështi duhet të transferohet menjëherë në një hapësirë tjetër të pastër dhe duhet pasur gjithmonë kujdes që të mos kontaminohet. Në stallë shmanget gjithmonë çdo përzjerje e qumështit nga një enë në tjetrën. Pajisjet e mjeljes mund të mbahen në të njëjtën hapësirë ku ruhet qumështi i papërpunuar, ose duhet të ketë një hapësirë tjetër të veçantë.

KUJDES!!!

- Nëse qumështi mblidhet përditë, atëherë duhet të ftohet në temperaturë jo më të lartë se 8°C;

- Nëse qumështi nuk mblidhet përditë, atëherë duhet të ftohet në temperaturë jo më të lartë se 6°C;

- Qumështi që për dy orë çohet për shitje, në qendrën mbledhëse ose në fabrikën për përpunim nuk duhet të ftohet.

KËRKESA PËR PAJISJE

Pajisjet e mjeljes duhet të jenë prej inoksi ose plastike të kategorisë ushqimore dhe duhet të jenë gjithmonë të pastra dhe të mirëmbahen rregullisht. Enët e qumështit nuk duhet të përdoren për asnjë qëllim tjetër. Pajisjet duhet të jenë gjithmonë të pastra dhe të mirëmbahen në gjendje të mirë. Zëvendësimi i rregullt i pjesëve të gomës ose silikonit duhet të bëhet sipas rekomandimeve të prodhuesit të pajisjeve.

CILA ËSHTË PROCEDURA THEMELORE E PASTRIMIT TË PAJISJES SIPAS FAZAVE?

Fillohet me përgatitjen, përkatësisht pastrimin mekanik. Pastaj bëhet një paralarje, përkatësisht shpëlarje me ujë. Larja bëhet me detergjent, i tretur në ujë në 85°C. Pastaj bëhet shpëlarja, më pas dezinfektimi dhe shpëlarja përfundimtare dhe procesi përfundon me tharje. Sfungjeri nuk guxon të përdoret, sepse përfaqëson shtrat dhe burim mikroorganizmash.

MASTITISI si faktor shumë i rëndësishëm do të përpunohet në mënyrë të detajuar në ndonjë prej numrave të ardhshëm të revistës "Toka ime".

Si ta mbrojmë bletën autoktone mjaltëdhënëse maqedonase

Apis mellifera macedonica

Popullatat autoktone përshtaten më mirë me kushtet lokale dhe mbijetojnë më gjatë. Kemi obligim moral dhe etik që t'i mbrojmë, kurse në këtë mënyrë e mbrojmë edhe mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve.

Bletarët maqedonas, kurse deri diku dhe opinioni më i gjerë e dinë se në territorin e shtetit tonë kultivohet një nënloj i veçantë i bletëve mjaltëdhënëse *Apis mellifera macedonica* ose bleta mjaltëdhënëse maqedonase. Ky nënloj i bletëve të mjaltit karakterizohet nga përshtatja e veçantë lokale në raport me kushtet mjedisore, me të cilat, natyrisht, përshtaten edhe bletarët me praktikën e tyre të bletarisë. Megjithatë, ajo popullsia përballet me një sfidë për ruajtjen e saj, sepse për shkak të globalizimit, shkëmbimit dhe tregtisë së lehtë, si dhe sjelljes së papërgjegjshme të individëve, ka një import të pakontrolluar të mbretërëshave që nuk janë me origjinë vendase dhe që sigurojnë çon tek të ashtuquajturit erozioni gjenetik i bletës mjaltëdhënëse maqedonase.

- Një nga mënyrat për të mbrojtur, kurse njëkohësisht, për ta përmirësuar gjenetikën e popullatës sonë vendase, është zbatimi i seleksionimit, d.m.th. programet e mbarështimit që do të realizohen si aktivitete në Maqedoni në dhjetë vitet e ardhshme. Megjithatë, gjatë realizimit të programeve përzgjedhëse, bletarët d.m.th. prodhuesit e mbretërëshave përballen me një sfidë në lidhje me zbatimin e kontrollit të çiftëzimit, kryesisht si rezultat i biologjisë specifike dhe komplekse riprodhuese të bletëve të mjaltit, si dhe për shkak të mungesës së vendeve të izoluar ku ato nuk mbahen bletë mjal-ti. Për një kohë të gjatë nuk kemi mundur ta tejkalojmë këtë problem apo handicap në programet e përzgjedhjes, pavarësisht përpjekjeve të prodhuesve të regjistruar për të identifikuar lokacione të tilla dhe për të krijuar të a.q. stacionet e fekondimit. Nëpërmjet projektit BeeConSel do të përpiqemi të identifikojmë disa lokacione të izoluar në Maqedoni ku mund t'i vendosim stacionet fekonduese, që në të vërtetë do të jenë edhe zgjidhje e problemit për kontroll të çiftëzimit.

Gjithashtu, si aktivitet apo synim shtesë, ngritja dhe përshtatja e avangardës të ashtuquajtur Metoda Joe Horner e cila është një alternativë për stacionet e fekondimit. Më pas, si një zgjidhje e tretë e mundshme, të cilën do të përpiqemi ta zbatojmë nëpërmjet projektit BeeConSel, është futja e inseminimit instrumental të mbretërëshave. Për këtë qëllim, në kuadër të Laboratorit për biologji dhe përzgjedhje të bletëve në Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqimore në Shkup, tashmë është siguruar aparati i ri për inseminimin instrumental të mbretërëshave, si dhe janë trajnuar 3 persona (bletarë dhe studentë) për përdorimin e tij. Kështu, nga viti i ardhshëm në Maqedoni, për herë të parë, inseminimi instrumental do të përdoret si një nga zgjidhjet për zbatimin e kontrollit të çiftëzimit të bletës të mjaltit. Vitin e kaluar, si dhe këtë vit, kemi qenë aktivë në terren, ku në lidhje me këtë problematikë arritëm të realizojmë një numër të madh hulumtimesh për të cilat duhet të theksojmë se kishim mbështetje kolosale nga bletarët maqedonas dhe i falënderoj ata sinqerisht.

Projekti Bikonsel (BeeConSel) financohet nga Fondi rajonal për bashkëpunim i Lihtenshtajnit, Islandës dhe Norvegjisë, kurse në Maqedoni zbatohet dhe bashkëfinancohet nga Shoqëria për kërkime të zbatueshme dhe arsim permanent në bujqësi DIPOZ që funksionon në suazat e Fakultetit e shkencave bujqësore dhe ushqim në Shkup. Projekti zhvillohet paralelisht në disa shtete evropiane si në Kroaci, Slloveni, Norvegji, Suedi dhe në Maqedoni këmbëngul të sigurojë çiftëzim të kontrolluar të bletës amë që të parandalohet hibridizimi i llojeve autoktone lokale që në rastin tonë është *Apis mellifera macedonica*. Zbatohet nga viti 2020 deri në fund të vitit 2023.



Prof. dr. Aleksandar Uzunov

Njëkohësisht, dua të shpreh mirënjohjen time për studentët e mi, të cilët, veçanërisht në vëzhgimet në terren, dhanë një kontribut vërtet të madh. Sinqerisht, shpresoj se nëpërmjet këtij projekti do të arrijmë ta tejkalojmë atë pengesë dhe të plotësojmë atë element që mungon në programet tona përzgjedhëse dhe kështu të kontribuojmë në përmirësimin gjenetik dhe mbrojtjen e popullatës vendase të bletëve në Maqedoni, tha profesor dr. Aleksandar Uzunov nga Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit nga Shkupi dhe koordinator i projektit në Maqedoni.

PËRVOJA NGA SLLOVENIA

- Dihet se bletaria në Republikën e Sllovenisë është e thurur në kulturën e komunitet dhe bleta e mjaltit e Kranjit (A. m. carnica) është disi krenaria jonë.

Hulumtohen një pjesë e karakteristikave dhe të gjitha regjistrohen në formularë të veçantë nga të cilët pas të gjitha analizave përzgjidhen mbretërëshat më të mira dhe përfshihen në një cikël të ri testimi. Ky proces ka dhjetë vjet që vazhdon, ndërsa ky është cikli i pestë dhe



Një moment nga testimi i metodës së Joe Horner në 2022

mund të thuhet se tashmë ka rezultate mjaft pozitive nga kjo përzgjedhje. Ajo që shohim në periudhën e pranverës, kur blidhen mbretëreshat, është se ka një publikim masiv të reklamave për shitjen e mbretëreshave që kryesisht deklarohen si gjermane dhe nuk dihet nëse janë vërtet të sjella nga Gjermani dhe për të cilat nuk ekziston dokumentacioni i nevojshëm, d.m.th. ato janë import ilegal. Më shpesh, bletarët e rinj dhe fill-estarët bien pas trukeve të tilla të marketingut të rishitësve dhe mashtrohen se mbretëreshat e tilla do të kenë rezultate më të mira prodhimi. Megjithatë, duhet të thuhet se është vërtetuar shkencërisht se speciet autoktone janë përshtatur ndaj faktorëve klimatikë, janë më jetëgjatë dhe kanë rezultatet më të mira të prodhimit, thotë inxhinieri i diplomuar i bujqësisë Goran Aleksovski, kryetar i Shoqatës maqedonase për mbrojtjen e bletës mjaltëdhënëse autoktone maqedonase.

Ju në Maqedoni keni një bletë mjaltë maqedonase, e cila, ndoshta për shkak të disa kushteve historike, nuk është aq e popullarizuar midis bletarëve në Maqedoni, siç është, për shembull, bleta e Kranjit midis bletarëve në Slloveni. Në vendin tonë përzgjedhja e mbretëreshës është bërë prej rreth 100 vitesh, që na jep përparësi në tregun e mbretëreshës. Në çdo përzgjedhje e rëndësishme është kontrolli i çiftëzimit të mbretëreshës dhe ky është një element që mungon si në Slloveni ashtu edhe në Kroaci e në Maqedoni. Pikërisht për shkak të kësaj ne nuk arrijmë përparimin gjenetik që dëshirojmë. Prandaj, partnerët e projektit nga Sllovenia, Maqedonia, Kroacia, Suedia dhe Norvegjia kërkuar mbështetje financiare për përmirësimin e kontrollit të çiftëzimit, nëpërmjet të cilit ne në fakt do të përmirësojmë përzgjedhjen dhe mbrojtjen e bletës lokale, e cila e ka dëshmuar veten në të kaluarën edhe me shkencë, u dëshmuar se u përshtatet më mirë kushteve lokale, tha asistenti profesor Dr. Janez Preshern nga Instituti Bujqësor në Slloveni.

BLETARI MUND TË NDIHMOJNË SHUMË VETEN

- Para së gjithash, bletarët duhet të rrisin familje bletësh nga bleta jonë vendase maqedonase, dhe në këtë mënyrë të demonstrojnë përgjegjësi dhe vetëdije për ruajtjen e diversitetit biologjik. Bletarët janë ata që me veprimet e tyre mund të ndihmojnë më së shumti në rrugën drejt mbrojtjes së bletës sonë të mjaltit, thotë profesor Uzunov. Për të shmangur blerjen e mbretëreshave që nuk janë me origjinë vendase, përkatësisht ato që importohen nga vendet dhe rajonet e tjera ku bleta është përshtatur me kushtet atje, jo me tonat. Do të jetë hapi i parë me të cilin bletarët do të mund të ndihmojnë në të gjithë idenë e mbrojtjes së A. m. Maqedonisë nga e cila në fund do të përfitojnë më së shumti. Mekanizmi apo procesi kyç është përzgjedhja sepse duke mbarështuar familjet e bletëve me mbretëresha me origjinë vendase, të cilat janë përmirësuar edhe

në aspektin e prodhimit të mjaltit, rezistencës ndaj sëmundjeve, sjelljes mbrojtëse të bletëve etj., bletarët do të motivohen të përdorin gjithnjë e më shumë ato gjenotipe dhe duke kontribuar kështu në ruajtjen e bletës maqedonase, shton Uzunov.

SHOQATA QË PUNON NË MBROJTJEN E BLETËS AUTOKTONE MAQEDONAS

Shoqata maqedonase për mbrojtjen e bletës mjaltëdhënëse autoktone maqedonase Makbi është formuar para 11 vjetësh dhe në të janë anëtarësuar 24 bletarë, prej të cilëve një pjesë janë ble-



Inxhinieri i diplomuar i bujqësisë Goran Aleksovski

tarë profesionalë, kurse për një pjesë bletaria është hobi. Shoqata nëpërmjet një sërë aktiviteteve punon në mbrojtjen dhe përparimin e bletës mjaltëdhënëse maqedonase dhe jemi të fokusuar te hulumtimet dhe edukimet. Hulumtimet realizohen në kosheret tonë, ndërsa çdo betar që është anëtar siguron nga 12 familje bletësh të cilat ndahen sipas një protokollit të përcaktuar rreptësisht. ●



Trajnimi i anëtarëve të rinj të Makbiut në Gjevgjeli

Ujitja solare i zvogëlon shpenzimet afatgjata në bujqësi

Përdorimi i energjisë solare është një nga mënyrat më aktuale dhe udhëheqës për shfrytëzimin e burimit të pashtershëm – Diellit

Energjia solare është burim i rinovueshëm i energjisë dhe prandaj ajo është burimi i parë i kompanive, fabrikave të mëdha, kurse këtu hyjnë edhe bujqit të cilët instalojnë panele në shtëpitë e veta, por edhe në plantacionet me fruta dhe vreshta si edhe në fusha. Në botën moderne roli dhe rëndësia e shfrytëzimit të burimeve të energjisë së rinovueshme është gjithnjë dhe më e madhe. Pavarësisht nëse dëshironi të ulni koston e energjisë elektrike të konsumuar në shtëpi apo të ulni koston e karburantit për pompimin e ujit në fusha apo plantacione, zgjidhjen mund ta gjeni në instalimin e paneleve diellore që prodhojnë energji elektrike. Përdorimi i burimeve natyrore ka qenë gjithmonë më i rëndësishmi. Sot njeriu modern nuk ikën nga natyra, por ndërthur teknologjitë e reja me natyrën për të krijuar shpikjet më praktike për një jetë dhe prodhim më efikas.

Arsyeja pse gjithnjë e më shumë fermerë po përdorin sistemet e ujitjes diellore qëndron në leverdinë e tyre që shihen në kursimet afatgjata. Sado që t'i përdorim burimet natyrore ajo është një temë e pashtershme, por sa mund ta përdorim diellin në bujqësi, këtu bëhet fjalë në radhë të parë për ujitjen me diell.

ÇFARË ËSHTË UJITJA SOLARE?

Ujitja solare siguron ujë të mjaftueshëm për bimët tuaja gjatë ditëve të verës dhe përdorimi i energjisë diellore bëhet burimi kryesor i procesit bujqësor. Ujitja me ndihmën e energjisë diellore përdoret në lloje të ndryshme të prodhimit bujqësor ku nuk ka akses në rrjetin elektrik dhe ku nuk ka mënyrë të përshtatshme për lidhjen e sistemit të ujitjes. Sistemi i stacioneve të pompimit diellor mund të përdoret në zonën e izoluar të fshatrave dhe me të reduktohet nevoja për pompa me naftë ose benzinë, si dhe reduktohet mirëmbajtja e sistemeve të tilla. Por skenari i tillë nuk është arsyeja e vetme e vendimit për përdorim të kësaj metode për ujitje, por më shpesh e përdorin ata bujq që dëshirojnë të zvogëlojnë shpenzimet dhe që synojnë fitim më të madh dhe mbrojtje ekologjike në prodhimtarinë e vet. Ujit-



ja solare përdoret për furnizimin me ujë me kosto të ulët të mirëmbajtjes dhe me përfitim më të madh në terma afatgjatë. Funksionimi i pompave të ujit sigurohet nga një panel diellor që konverton rrezet e diellit në energji elektrike. Pompa të tilla diellore janë të përshtatshme për aplikim aty ku nuk ka akses në rrjet elektrik dhe ka burime uji si puse, ujëra nëntokësore, përrrenj, kanale ose pellgje.

BENEFITI DHE KURSIMI NË BUJQËSI NGA PËRDORIMI I SISTEMEVE SOLARE

Përparësitë e pompave solare për ujitje në raport me ato konvencionale elektrike janë të shumta:

1. Pompat solare për ujitje nuk kanë nevojë për asnjë lloj karburanti apo rryme.
2. Mjafton instalim i thjeshtë për të cilin nuk keni shumë shpenzime.
3. Pompat solare nuk kanë problem me presionin e ulët të rrymës ose humbjen e një faze.
4. Mund të instalohe në rajonet e largëta rurale ku nuk ka rrjet energjetik ose është e vështirë të çohet karburant.

5. Kanë shpenzime të ulëta për mirëmbajtje sepse pompat solare kanë shumë pak pjesë lëvizëse në krahasim me pompat me karburant, kurse kështu ka më pak shanse për ndryshkje dhe defekte.

6. Nuk nevojiten lyerje ndërkohë që punojnë kështu që nuk ka mundësi për kontaminim të ujit ose tokës.


7. Janë të pranuar ekologjikisht.

8. Janë të thjeshta për punë.

PANELET SOLARE KANË JETËGJATËSI MË TË MADHE

Energjia solare është burim i rinovueshëm i energjisë dhe pikërisht për këtë gjë është burimi kryesor i çdo sistemi më serioz. Shfrytëzimi i diellit nënkupton edhe mbrojtje të mjedisit ekologjik. Panelet solare kanë performanca të garantuara të punës. Pas përfundimit të 25 vjetëve madje edhe më shumë, panelet solare edhe mandej i ruajnë 85% të performancave të veta duke e arsyetuar shumëfish investimin fillestar.

Burimi: www.bif.rs (Biznis I Finansije)



Prezantimi i mundësive të dronëve në bujqësi

Në fushat në Baranja para bujqve të mbledhur bujqit u prezantuan mundësitë dhe performancat e dronëve spërkatës



Dronët po bëhen të njohur dhe gjejnë zbatim të ndryshëm në përditshmëri dhe në bujqësi. Po futen ngadalë edhe në rajonet tona, kështu që në fushat jo larg Dardes u mbajt prezantim i mundësive që i kanë dronët spërkatës. Edhe pse normativa evropiane 2009 është pengesë për zbatimin e pesticideve nga ajri, megjithatë kjo teknologji po përdoret para së gjithash për shkak të praktikës agronomike.

“Franca dhe Gjermania kanë miratuar përdorimin e dronëve në ato plantacione vreshtash ku është e vështirë ose e pamundur për traktorët të aksesojnë dhe të mbrojnë, kurse përdoren në një masë më të vogël sot në Portugali dhe Spanjë”, tha Zolt Eginer, përfaqësues. fermerëve të mbledhur nga një kompani që përfaqëson dronët nga Hungaria.

Ai shtoi se edhe vendet e tjera evropiane kanë nisur rrugën drejt rregullimit ligjor të përdorimit të dronëve në bujqësi dhe lejohet përdorimi për ata që kalojnë kursin për menaxhim të sigurt të këtyre pajisjeve fluturuese. Gjatë një pasdite me diell, tridhjetë fermerë të mbledhur morën një sasi të madhe informacioni rreth modeleve Agras T30 dhe Agras T10, të cilat operatori i menaxhoi me mjeshtëri në fushë me grurë të mbirë



dhe demonstroi aftësitë e tyre. Ndryshe nga bota e mekanizimit, ky segment teknologjik është dominuar nga prodhuesi kinez DJI që nga fillimi i tregut, i cili sipas të dhënave mban 70% të tregut global të dronëve vitin e kaluar.

Këto pajisje të forta dhe njëkohësisht të lehta janë punuar nga kompozita karboni, janë dizajnuar në një mënyrë që pas përdorimit të mund të paktohen dhe grumbullohen lehtësisht në çdo automjet, përkatësisht, për modelin më të madh T30 me siguri do të nevojitet furgon ose pik ap për transferim nga një pikë te tjetra. Të dy modelet kanë kamera, por edhe një sistem radar me sensorë që mundëson shmangien e objekteve që mund të gjenden në terren, si linjat e energjisë elektrike, puse, pemë etj. Një njësi përfshin gjithashtu konsolën e kontrollit me valë që ka monitor që siguron nivel të lartë sigurie, saktësie dhe një numër të madh informacionesh të ndryshme për personin që e kontrollon.



MODELI DJI AGRAS T30

Ky model ka 6 krahë dhe mund të trajtojë një sipërfaqe prej 16 hektarësh në një orë pune. Ka rezervuar prej 30 litrash në të cilin vendosni tretësirën për aplikim. Ka 16 spërkatës që mbulojnë një gjerësi pune prej 9 metrash. Bateria lehtësisht e zëvendësueshme ka një kapacitet prej 29 mijë mAh me një peshë prej 10 kg që ngarkohet me një karikues të shpejtë që vjen në komplet me këtë dron.

MODELI DJI AGRAS T10

Ky model droni ka përmasa pak më të vogla. Ai ka një rezervuar 8 litra dhe 4 spërkatës, kurse fuqizohet nga një motor me 4 krahë ku janë vendosur helikat. Zona më e madhe e punës është 5.5 metra e gjerë, kurse kur aplikohet, fluturohet në një lartësi nga 1.5 deri në 3 metra mbi të korrat me një konsum prej 3 litra tretësirë në minutë.

ZBATIMI PRAKTIK ËSHTË I QARTË, POR ÇËSHTJE E PASHMANGSHME ËSHTË ÇMIMI I TYRE.

Sipas të dhënave në internet, në rrjetin e shitës zbulohet se modeli më i madh T30 në model themelor shitet rreth 10 500 euro, kurse modeli më i vogël shitet 5 500 euro në të cilat duhet të llogariten edhe shpenzimet për transport dhe import.

Burimi: agrokub.hr

BUJQ, NE E USHQEJMË BOTËN

Përpunime frutash me shitje nga pragu i shtëpisë

Shkruan: Biljana Petrovska-Mitrevska

Familja Trantallovski nga fshati prespan Evlla që ka 6 anëtarë dhe në të cilën të gjithë janë të përfshirë aktivisht në prodhimtarinë bujqësore familjare, përpunon rreth 20 hektarë. Prej këtyre sipërfaqeve 7 hektarë janë me mollë, 1 hektar me mjedra, kurse 12 hektarë janë me lajthi. Të mbjellat me mollë janë më të vjetrat, kurse plantacioni me lajthi është ngritur para 12 vjetësh, kurse plantacioni me mjedra kultivohet intensivisht në 7 vitet e fundit. Sipas kryefamiljarit, Pere Trantallovskit, varietetet e mollës janë të ndryshme, por dominon ajdareti (hidare) me 80%, kurse ka edhe një pjesë me golden delicious, çadel dhe pak muco dhe jona-gold. Kushtet klimatike dhe fatkeqësitë e motit, si dhe problemet me plasmin ishin vendimtare që të nisët një prodhimtari e re si zëvendësim i të mbjellave me mollë.

- Motivimi ynë i parë ishin subvencionet e prezantuara për plantacionet e reja të lajthisë, kurse arsye ishte se diçka duhej të ndryshonte sepse filluam të kishim shumë shpesh vite të këqija në prodhimin e mollës. Atëherë subvencionet mbulonin pothuajse gjithçka që lidhej me ngritjen e një plantacioni të ri me lajthi, kurse me mollët filluam ta ndjejmë mbylljen e tregjeve, çmimet filluan të bien, problemet me ndryshimet klimatike nga ngricat dhe dëmtimet nga breshëri u bënë gjithnjë e më të shpeshta dhe kur do të mbetet pjesa më e madhe e prodhimit e dëmtuar dhe e destinuar për industrinë ose



për shkak të ngricave nuk do të ketë prodhim, atëherë viti mezi mbijetohet. Bahçet e lajthive janë rritur gradualisht dhe tani jemi në 50% të sipërfaqeve në prodhimtari të plotë. Nga lajthitë ka më shumë të ardhura kur ato hyjnë në prodhim të plotë. Nuk kemi trajtime kimike aq sa me mollët. Lajthia është një investim afatgjatë nga i cili kemi një prodhim të plotë për 30-40 vjet dhe vetëm kur ajo është afër fundit dhe prodhimi fillon të ulet, fillojmë duke zëvendësuar degët e vjetra me të reja të cilat të rriten nga vetë rrënjët dhe kështu e zgjasim sërish jetën e saj prodhuese gjë që nuk është e pranishme te mollët. Kur bëjmë krahasime, e kuptojmë se te mollët punojmë nën çmimin e prodhimit, kanë jetëgjatësi më të shkurtër dhe për këtë arsye lajthia tashmë është zëvendësues i shkëlqyer për ne, tha Pere Trantallovski.

Mollët mbeten në atë sipërfaqe që i kam sepse fillova me prodhimin e lëngut Prespino i cili është brend i lëngut

që përfitohet me shtrydhje të ftohtë nga molla pa shtuar ujë edhe sheqer dhe është 100% natyror.

Prodhimi i lëngut të parë nga një operator i vogël ushqimi, Prespino mbështetet nga projekti "Zhvillimi organizativ i FNF-së dhe përmirësimi i lidhjeve tregtare për bujqit dhe prodhuesit e vegjël nga mjediset rurale" me qëllim të zmadhimit të të hyrave të tyre, që zbatohet nga Federata nazionale e fermerëve me mbështetje nga Organizata suedeze për zhvillim We Effect dhe Agjencia suedeze për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim, SIDA, shtoi Trantallovski.

Pajisjet për prodhimin janë blerë plotësisht. Tani mbetet të ndërtohet një hapësirë e veçantë për prodhimin e lëngjeve, kurse vizioni i Trantallovskit për të ardhmen është që ta bëjë të gjithë linjën e përpunimit dhe prodhimit të lëngjeve mobile. Ideja e tij është që të vendosë të gjitha pajisjet e prodhimit të lëngjeve në një rimorkio dhe të jetë në gjendje ta bëjë shërbimin e prodhimit të lëngut natyral të mollës më në akses në vend që t'i japë industrisë mollët e klasës së dytë për para minimale. Kjo është kryesisht për shkak të marrëdhënies bashkëpunuese që ai ka me dhjetëra fermerë nëpërmjet projektit nga të cilët mollët blihen dhe u paguhen me kushte më të mira sesa nëse do t'i jepnin për industri.

- Do të vazhdojmë me prodhimin e lëngut Prespino edhe në të ardhmen. ●



Adi Muso një shembull për t'u ndjekur nga të rinjtë që jetojnë dhe punojnë në zonat rurale

Përgatiti Nikolin Karapançi

Në Shqipëri bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e vendit, por njëkohësisht një nga më problematikët dhe më të braktisurit nga të rinjtë. Fenomeni i braktisjes së jetës në fshat dhe punës në bujqësi nga të rinjtë u bë shumë serioz për faktin sepse jeta dukej e vështirë dhe me të ardhura të vogla. Kështu që shumica e të rinjve iu drejtuan qendrave urbane dhe emigracionit drejt vendeve të Bashkimit Evropian kryesisht Greqi, Itali etj., për faktin që jo vetëm që nuk e gjen veten në këtë sektor, por përkundrazi e quan fyerje dhe ulje të figurës së tij të marrit me bujqësi. Mungesa e të rinjve në zonat rurale ka detyruar prindërit e tyre të punojnë për një kohë më të gjatë dhe në një moshë më të madhe.

Në ditët e sotme tendenca e të rinjve për t'u larguar nga fshati nuk mund të themi që është eliminuar fare por kohët e fundit ka shenja të cilat tregojnë që disa të rinj vazhdojnë jetën në fshat për të punuar në fermat e tyre por dhe shumë të tjerë janë kthyer nga emigracioni.

Prandaj dhe nxitja e të rinjve për të punuar në fermë është një nga objektivat e projektit "Mbështetje për rritjen e kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rural", zbatuar nga AgriNet Albania dhe mbështetur nga We Effect, Suedi. Një shembull konkret i një fermeri të ri i cili punon në fermën e tij të trashëguar nga i ati është edhe Adi Muso, kryetar i Grupit të fermerëve të rinj Progër në Rajonin e Korçës, i cili i pyetur rreth aktivitetit në fermën e tij, ai shprehet si më poshtë:

"Unë jam Adi Muso banoj dhe ushtroj aktivitetin në fermën time në fshatin Progër të Rajonit të Korçës, gjithashtu



prej dy vitesh jam kryetar i Grupit të fermerëve të rinj Progër anëtar i organizatës AgriNet Albania.

Duke qenë se ishte tepër e vështirë të gjeja punë dhe të ardhura stabile në emigracion por edhe në disa zona urbane të Shqipërisë vendosa që të kthehem dhe të punoj në fermën e trashëguar nga babai im. Një fermë që në fillesat e saj përbëhej prej vetëm 5 hektarësh të kultivuar me mollë të varietetit hidare me një prodhim mesatar vjetor prej 100 ton. Por duke marrë në dorë punën në fermë vendosa të punoj, bashkëpunoj, të përfitoj dije, njohuri, eksperiencë si dhe shumë mbështetje në formë grantesh dhe subvencionesh nga organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare ku një ndër to është edhe AgriNet Albania. Falë eksperiencës së fituar dhe mbështetjes së marrë kam arritur që sot ta dyfishoj sipërfaqen e mbjellë me mollë duke e çuar në 10 hektarë duke futur varietete të reja si Star King, Golden Delicious dhe Fuji, dua të përmend këtu mbulimin me sistemin me rrjeta antibreshër të 2 hektarëve, por edhe ndërtimin e një frigoriferi për ruajtjen

e prodhimit më një kapacitet ruajtës prej 1300 ton. Të gjitha këto kanë bërë që të ardhurat e familjes të dyfishohen duke siguruar një jetesë komode dhe një garanci për të ardhmen.

Për sa i përket të ardhmes synoj që sipërfaqen e tokës të kultivuar me mollë ta çoj deri në 15 ha duke futur edhe teknologjinë intensive të prodhimit të mollës dhe pse jo të mbuluar të gjithën me sistemin me rrjeta antibreshër, ndërsa ambientet frigoriferike të ruajtjes dua t'i çoj në një kapacitet prej 2000 ton duke futur edhe sistemin e ruajtjes me atmosferë të kontrolluar.

Për të përfunduar fjalën time dua t'u bëj një apel të rinjve shqiptarë, por dhe atyre të rajonit të cilët jetojnë në fshat që të mos e kenë mendjen vetëm të largohen dhe të braktisin jetën në bujqësi dhe në fermë për të kërkuar një jetë më të mirë në qytet apo në emigracion. Por të qëndrojnë të punojnë tokën dhe të shtojnë fermën e trashëguar nga prindërit e tyre sepse është vërtet një vlerë e pazëvendësueshme", me këto fjalë e ka mbyllur historinë e tij të suksesit fermeri Adi Muso. ●



Dake Gjoni nxitëse e lidërshiptit dhe sipërmarrjes së grave

Shkroi: Elinarda Kolgjokaj

Dake Gjoni është anëtare dhe një nga bashkëpunëtoret më të vjetra të shoqatës AgroPuka. Ajo është 58-vjeçare, bashkëshorte dhe nënë e katër fëmijëve, me profesion agronome, aktualisht mësuese biologjie dhe kimie në fshatin e saj, anëtare dhe drejtuese e grupit të grave Qelëz. Dake është gjithashtu anëtare e Bordit drejtues të Shoqatës "Agropuka".

Ideja e krijimit të një grupi grash erdhi nga nevoja e madhe për të angazhuar veten dhe gratë e tjera në komunitetin ku jeton, ku një nga sfidat më të prekshme vazhdon të jetë fuqizimi i grave në zonat rurale. Grupi u themelua 18 vjet më parë me



vetëm 5 anëtarë. Tani grupi përbëhet nga 30 anëtarë dhe Dake dëshiron që ai të rritet edhe më shumë duke përfshirë dhe të rinjtë. Ajo shprehet se i inkurajon nënat që t'i sjellin fëmijët e tyre në takime dhe se të rinjtë duhet të përfshihen më shumë në aktivitete avokuese mbi të drejtat dhe impaktin e tyre në vendimarrje.

Si përfaqësuese e Këshillit konsultativ të grave për Bashkinë Pukë, ajo ka qenë shpeshherë pjesë e takimeve dhe diskutimeve, duke ngritur zërin për sfidat dhe nevojat e grave në zonën e saj me synimin ndërgjegjësimin për të krijuar modele efikase që kanë në fokus forcimi i rolit të gruas në komunitet dhe në zhvillimin rural.

Dake prej disa vitesh drejton Qendrën e trajnimit të përpunimit të fruta-perimeve me një grup grash në fshatin Qelëz. Ajo trajnon gratë dhe të reja në përpunimin e frutave dhe perimeve. E veçanta e tyre është se nuk përmbajnë konservues dhe janë fruta dhe perime nga kopshtet e tyre. Pjesëmarrësit jo vetëm që trajnohen, por diskutojnë edhe çështje që lidhen me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, vendimarrjen dhe klimën.

Pavarësisht profesionit të saj si mësuese dhe detyrimeve shtëpiake, ajo është e pranishme në çdo aktivitet dhe panair që organizon AgroPuka, si dhe gjendet çdo fundjave në tregun e qytetit për të shitur fruta dhe perime për qytetarët së bashku me gratë e tjera të fshatit, ku për 18 vjet ata janë tashmë në treg me produktet e tyre.

Që nga viti 2015, Dakja është e angazhuar gjithashtu si lidere dhe organizatore e metodologjisë së rrethit të studimit. Këtë vit, së bashku me një grup grash dhe vajzash të reja kanë menduar për vazhdimësinë e rrethit studimor të një viti

më parë me temë: "Krijimi i elementeve të reja të veshjeve tradicionale të zonës", ku thekson se një ndër objektivat kyç është të ruajmë dhe të përcjellim te brezat e ardhshëm, trashëgiminë kulturore që na kanë lenë të parët.

Për më tepër Dake është këshilluese e shoqatës Agropuka dhe organizon trajnime me fermerë në fushën e prodhimit bujqësor dhe marketingut të produkteve, si dhe shkëmbime të përvojave të fermerëve me njëritjetrin dhe me fermerë të tjerë në Pukë dhe bashki të tjera. ●



Ndikimi i krizës aktuale mbi çmimin e kostos së prodhimeve bujqësore

Indeksi i çmimeve në bujqësi në qershor të vitit 2022, krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, tek inputet është rritur me 26% sipas ESHS-së, njëkohësisht, çmimet e blerjes së produkteve bujqësore nuk ndjekin të njëjtën dinamikë, përkatësisht, sipas të dhënave të qershorit 2022, rritja e çmimeve tek autputi i prodhimit bimor është rreth 9%, kurse te prodhimi blegtoral me 12% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Shkruan: Prof. dr. Aleksandra Martinovska-Stojćeska, Fakulteti për Shkencat Bujqësore dhe Ushqim – Shkup (UKEM)

Struktura dhe niveli i çmimit të kostos së prodhimeve bujqësore kanë implikime të rëndësishme mbi të hyrat e vetë prodhuesve, si dhe mbi konkurrencën në të gjithë sektorin. Kostot e prodhimit ndikojnë në zhvillimin e sistemeve bujqësore, qëndrueshmërinë e tyre dhe potencialin e përgjithshëm për prodhimin e ushqimit. Prandaj, analiza e çmimit të kostos paraqet një mjet të fuqishëm për të kuptuar dhe krahasuar kushtet e konkurrencës së sistemeve të ndryshme bujqësore dhe linjave të ndryshme të pro-

dhimit bimor dhe blegtoral.

Përcaktimi i çmimit të kostos është i një rëndësie të veçantë në kushtet e krizës, siç është kriza e shkaktuar nga pandemia dhe veçanërisht situata aktuale me luftën në Ukrainë, e cila ka shkaktuar çrregullime të mëdha në tregjet globale të inputeve dhe produkteve bujqësore. Federata Ruse dhe Ukraina janë ndër prodhuesit dhe eksportuesit neto më të rëndësishëm të produkteve bujqësore në botë dhe në të njëjtën kohë furnizuesit kryesorë me plehra në tregjet globale.

Të dy vendet renditen ndër tre eksportuesit kryesorë botërorë të grurit, elbit, misrit, vajit të rrepës dhe farave të rrepës, farave të lulediellit dhe vajit të lulediellit. Federata Ruse renditet, gjithashtu, si eksportuesi më i rëndësishëm në botë i plehrave azotike, furnizuesi i dytë kryesor i plehrave me kalium dhe eksportuesi i tretë më i madh i plehrave fosforike.

Prandaj, efektet e luftës në Ukrainë shkaktuan rritje të ndjeshme të çmimeve të produkteve kryesore bujqësore, si në nivel global, ashtu ►►



► edhe te ne, të cilat ndikuan drejtpërdrejt mbi çmimin e produkteve bujqësore. Para së gjithash, duke pasur parasysh se kostot e të ushqyerit të bimëve zënë mesatarisht rreth një të pestën e kostove to-

tale të prodhimit për kulturat perimore (me peshën më të lartë prej rreth një të tretës për kulturat e drithërave), rritja e shumëfishtë e çmimit të plehrave artificiale për ushqimin bazë dhe ushqimin sht-

esë të bimëve në kulmin e sezonit të prodhimit ndikuan ndjeshëm mbi kostot e prodhimit. Rritja drastike e çmimeve të karburanteve me më shumë se 50% ndikoi edhe në rritjen e çmimit të operacioneve agroteknike, mbi të gjitha për punimet bazë dhe shtesë, transportin, ujitjen e të mbjellave etj. Çmimet e materialit farë dhe të produkteve për mbrojtjen e bimëve shënuan një rritje të caktuar, por më të moderuar prej rreth 10%. Këtë situatë e shënon edhe Enti Shtetëror i Statistikës, që sipas të dhënave më të fundit, indeksi i çmimeve në bujqësi në qershor 2022, krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, për inputet është rritur me 26%, që sipas vlerësimeve fillestare, korrespondon me rritjen e çmimit vjetor të shumica e kulturave në vendin tonë krahasuar me vitin e kaluar. E ngjashme është situata edhe në prodhimtarinë blegtorale, ku edhe zëri më i madh në kostot e sigurimit të ushqimit të kafshëve ka shënuar rritje të ndjeshme (të paktën nga 10 deri në 20%). Qasja te fuqia punëtore dhe çmimi i saj mbeten sfida e cila e vështirëson, gjithashtu, procesin e prodhimit dhe ndikon mbi suksesin në punë. ●



Mbrojtja gjatë punës me traktor

Nëse personi që menaxhon traktorin u përmbahet masave të dhëna të sigurisë gjatë punës, mundësia të ndodhë fatkeqësi është në minimum

Shkruan: Prof. dr. Dragi Tanevski

Traktoristët, përkatësisht ata që i menaxhojnë pajisjet bujqësore janë të pasqyruar ndaj rreziqeve të shumta. Prandaj është e rëndësishme të njihen rregullat më të rëndësishme të mbrojtjes gjatë punës. Nëse shoferi i njeh rregullat e mbrojtjes gjatë punës siguron veten, por edhe punëtorët e tjerë të cilët e ndihmojnë në kryerjen e punëve të ndryshme të komplikuara. Për kryerjen e punëve bujqësore në kushte të pafavorshme të motit, tokës dhe relievit, duhet të përdoret traktor që ka kabinë me sedilje të integruar për shoferin, mundësisht edhe për pasagjerin. Kabina duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë ndërtuar në mënyrë të tillë që të ketë mbrojtje për shoferin në rast të përmbysjes;
- ta mbrojë shoferin nga fatkeqësitë e motit dhe pluhuri;
- të ketë konstruksion që nuk do të pengojë gjatë kryerjes së punës;
- të mundësojë shikim të mirë

në të gjitha anët, veçanërisht të makinerive rimorkio;

- në pjesët anësore të ketë dyer me dritare të cilat mund të hapen.

Xhamat e dritareve të mundësojnë pamje të mirë, ndërsa të mos jenë të thyeshëm. Traktori me kabinë duhet të ketë pajisje, përkatësisht mjet për rregullim dhe nxjerrje të lehtë të kabinës. Traktori me rrota gome duhet të ketë një kornizë mbrojtëse nëse nuk ka kabinë dhe duhet të sigurojë mbrojtje të besueshme për punëtorin kur traktori përmbysset. Traktori që përdoret për të punuar me makineri për mbrojtjen e bimëve duhet të ketë kabinë të mbyllur hermetikisht, nëse përdoren agjentë kimikë (helme) për mbrojtjen e bimëve. Traktorët që synojnë të punojnë në terrene me pjerrësi më të madhe se 20% duhet të pajisen me tregues të këndit të pjerrësisë. Pikat për pjerrësinë e lejueshme dhe kritike duhet të shënohen në tregues. Traktoristi duhet të respektojë udhëzimin për përdorim të traktorit sidomos në aspektin e mbingarkimit më të madh të lejuar.

Gjatë punës, traktoristi duhet të pajiset me pajisje adekuate mbrojtëse

kundër ekspozimit të tepërt ndaj rrezeve të diellit, pluhurit, preparatëve kimike - të dëmshme për shëndetin e njeriut. Ndalohet puna me traktor me defekt. Çdo mangësi apo defekt duhet të mënjanohet para nisjes nga vendi.

Para ndezjes së motorit, traktoristi duhet të kontrollojë nëse kutia e shpejtësisë është në neutral. Kur motori është në punë, ndalohet furnizimi me karburant, vajra të motorit dhe riparim i traktorit. Traktoristi nuk guxon ta përdorë traktorin nëse është nën ndikimin e alkoolit

MASAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJE GJATË PUNËS ME TRAKTOR

Gjatë prodhimit të traktorëve, qëllimi kryesor i çdo prodhuesi është të prodhojë traktor sa më të sigurt për shoferin. Nëse edhe shoferi u përmbahet gjithashtu paralajmërimeve të renditura më poshtë, mundësia e një aksidenti reduktohet në minimum.

Drejtimi i traktorit mund të kryhet vetëm nga person që ka kualifikime të përcaktuara dhe ka dhënë ►►



- provimin e drejtuesit të traktorit. Robat e punës duhet të jenë të përshtatshme për punë me traktor dhe punë të tjera bujqësore. Më të mira janë kominoshet ose kostum pune ku mund të lidhen mëngët, në mënyrë që të mos kapet ndonjë pjesë e veshjes nga ndonjë pjesë rrotulluese e traktorit ose makinerisë tjetër bujqësore. Veshjet e punës duhet të jenë të pas-tra, pa yndyrë, sepse në rast zjarri ka mundësi që të marrin flakë shpejt.

Te traktorët, të gjitha vendet që paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë duhet të sigurohen. Çdo traktor duhet të ketë pajisje sigurie që shërben për të mbrojtur drejtuesin nga lëndimi gjatë ndonjë përmbysjeje anësore ose përmbysjes nga pas. Pajisjet mbrojtëse duhet të jenë të lidhura fort me trupin e traktorit dhe duhet të jenë në masë të përshtatshme me masën dhe llojin e traktorit. Ato duhet të jenë mjaft të forta dhe të mos lejojnë të ndodhin deformime të caktuara të kabinës, të cilat paraqesin rrezik të menjëhershëm për shoferin, nëse traktori përmbysset.



Në rastin e traktorëve me zvarritës, në të cilët frenimi kryhet vetëm me dy rrotat lëvizëse të zvarritësve, frenat për rrotat lëvizëse dhe për parkim mund të jenë të përbashkëta nëse të paktën 70% e masës totale të traktorit zvarritës qëndron në shina.

Peshat shtesë, të cilat duhet të qëndrojnë përgjithmonë në traktor, nuk duhet të kenë vende të rrezikshme që mund të çojnë në shtypje ose prerje. Të gjithë elementët e transmisionit të traktorit dhe makinerive të bashkangjitura duhet të mbrohen me rrjetë ose mbulesë.

Boshti i kardanit duhet të ketë mbrojtje të veçantë që parandalon kapjen e rrobave të punës dhe dëmtimin e personit, nëse bie në kontakt me të. Megjithatë, nëse boshti i kardanit është në lëvizje, nuk rekomandohet të qëndroni pranë tij, sepse në rast thyerjeje mund të ndodhin lëndime serioze.

Gjatë drejtimit të traktorit, në të

mund të jetë vetëm drejtuesi i traktorit. Mund të hipë edhe një person, por atëherë traktori duhet të ketë të instaluar vend shtesë. E gjithë puna në traktor dhe makinat e bashkangjitura mund të kryhet vetëm kur motori është i fikur dhe makina e bashkangjitur është ulur në tokë. Para se të ndizni motorin, nevojitet të kontrolloni nëse leva e marshit është në pozicion neutral dhe a është leva e lëvizjes së boshtit lidhës e fikur, kur në traktor është agreguar ndonjë makineri bujqësore. Përveç kësaj, ndalohet ndezja e motorit nëse shoferi nuk është në vendin e tij. Përpara se të filloni të shtypni pedalin, bashkuesja duhet të shkëputet. Gjithashtu, para fillimit, duhet të kontrollohet që askush të mos jetë para traktorit ose midis traktorit dhe makines së bashkangjitur. Pas ndalimit të traktorit, leva e marsheve duhet të vendoset në pozicionin neutral. Nuk lejohet hipja apo zbritja në traktor kur ai është në lëvizje. Puna e natës me traktor lejohet nëse ka pajisje ndriçimi adekuate dhe korrekte. ●

Informacione të dobishme për gratë nga zonat rurale

KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT MBI GRATË (CEDAW)

Barazia e të drejtave të grave është parim i themelor i OKB-së. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në Paris më 10 dhjetor 1948 miratoi Deklaratën Universale të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Në preambulën e Kartës së Deklaratës Universale të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të OKB-së, barazia gjinore është vendosur si një nga qëllimet qendrore të organizatës në lidhje me riafirmimin e besimit në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personalitetit njerëzor, në të drejtat e barabarta të burrave dhe grave.

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW) u miratua nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979 dhe është një nga dokumentet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të grave. Maqedonia e ratifikoi Konventën në vitin 1994.

CEDAW i afirmon parimet e barazisë dhe drejtësisë ndërmjet gjinive dhe u drejton kërkesa shteteve nënshkruese për të marrë masat e duhura, përfshirë ato legjislative, për të garantuar respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.

Sipas CEDAW detyra kryesore e shtetit është në institucionet kombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore t'i njohë të drejtat njerëzore të grave dhe në të gjitha sferat të sigurojë mbrojtjen e tyre.

Konventa përmban 16 nene, në nenin 14 që janë përfshirë në gratë nga mjediset rurale: gratë rurale kanë të drejtën e jetës me dinjitet, pjesëmarrjes në krijimin e politikave zhvillimore dhe bujqësore, qasjes në arsim, shërbimeve sociale dhe shëndetësore, transportit dhe shërbimeve financiare.

AGJENDA 2030 PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM: "TRANSFORMIMI I BOTËS SONË"

Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) përfaqësojnë një grup prej 17 qëllimesh, 169 qëllimesh specifike dhe 230 indikatorësh për promovim. Ndryshe, ato njihen edhe si qëllimet globale dhe i prekin të gjithë sektorët e qeverisjes dhe zhvillimit dhe bëjnë thirrje

për veprim nga të gjitha vendet. Agjenda 2030 është globale nga natyra dhe universale në zbatim, prandaj është e zbatueshme për të gjitha vendet, si për të zhvilluarat ashtu edhe ato në zhvillim, duke marrë parasysh kushtet e ndryshme kombëtare, kapacitetet dhe nivelet e zhvillimit.

Dokumenti përmban 17 Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm, nëpërmjet të cilave parashikohet t'i jepet fund varfërisë ekstreme, pabarazisë, padrejtësisë dhe të mbrohet planeti ynë. Kjo agjendë ka një kohëzgjatje dhe afat për t'u përmbushur deri në vitin 2030. Aktorët kryesorë në zbatimin e Agjendës 2030 janë qeveritë e vendeve, të cilat duhet të përshtatin politikat që pasqyrojnë realitetet e tyre kombëtare dhe të ofrojnë struktura rregullatore dhe nxitëse për të ndihmuar në arritjen e qëllimeve të reja.

Qëllimi nr. 5 lidhet me barazinë gjinore, kurse bujqësia është e theksuar veçanërisht në Qëllimin nr. 2.

Qëllimi nr. 2: T'i jepet fund urisë, të arrihet siguri në ushqim dhe përmirësim i ushqimit dhe të promovohet bujqësia e qëndrueshme. Në këtë qëllim theksohet se deri në vitin 2030 duhet të dyfishohen prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve të vegjël të ushqimit duhet, veçanërisht të grave, familjeve bujqësore, blegtorëve dhe peshkatarët, të përfshirë nëpërmjet aksesit të sigurt dhe të barabartë në tokë, burime dhe inpute të tjera prodhuese, njohuri, shërbime financiare, tregje dhe mundësi për realizimin e vlerave shtesë dhe forma të tjera jobujqësore të punësimit. Të sigurohen sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe të zbatohen praktika bujqësore adaptive që e rrisin produktivitetin dhe prodhimin dhe ndihmojnë në ruajtjen e ekosistemeve dhe forcimin e kapacitetit për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike, kushtet ekstreme të motit, thatësitat, përbytjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore, si dhe të sigurohet përmirësim gradual i tokës dhe i cilësisë së tokës. Njëkohësisht, të ruhet shumëllojshmëria gjenetike e farërave, bimëve të kultivuara, rritja e investimeve në infrastrukturën rurale dhe kërkimet bujqësore dhe të parandalohen çfarë çdo kufizimesh tregtare në tregun botëror bujqësor dhe të miratohen masa për të siguruar funksionimin e duhur të tregut ushqimor dhe të lëndëve të para të tij për prodhim.

Qëllimi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe përforcimi i grave dhe vajzave. Në këtë qëllim theksohet se duhet të ndalojnë të gjitha llojet e diskriminimit ndaj grave dhe vajzave, eliminimi i të gjitha llojeve të dhunës dhe sigurimi i qasjes universale të mbrojtja e shëndetit seksual dhe riprodhues, eliminimi të të gjitha praktikave të dëmshme, si martesat e fëmijërore, të hershme dhe të detyrueshme. Njohja dhe vlerësimi i punës së papaguar dhe punës shtëpiake duke ofruar shërbime publike, infrastrukturë dhe politika të mbrojtjes sociale dhe duke inkurajuar përgjegjësinë e përbashkët për amvisërinë dhe familjen, në përputhje me rrethanat nacionale. Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta për pozita drejtuese në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike. Ndërmarrja e reformave për t'u siguruar grave të drejta të barabarta për burimet ekonomike, si dhe akses në pronësi dhe kontroll mbi tokën dhe llojet e tjera të pronave, shërbime financiare, trashëgimi dhe burime natyrore, në përputhje me legjislacionin nacional dhe përmirësimin e përdorimit të teknologjisë së informacionit, si dhe miratimi dhe përforcimi i politikave të forta dhe ligje të zbatueshme për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.

KONVENTA E STAMBOLLIT

Këshilli i Evropës e miratoi Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës mbi gratë dhe dhunës familjare (e njohur si "Konventa e Stambollit"). Konventa e Stambollit është pranuar gjerësisht si instrumenti juridik më largpamës në parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare, si një nga format e shkeljes së të drejtave të njeriut. Konventa hyri në fuqi në vitin 2014, vetëm tre vjet pas miratimit të saj, duke demonstruar nevojën që shtetet anëtare të kenë një marrëveshje ndërkombëtare ligjërish të detyrueshme mbi të cilën do të bazohen përpjekjet për parandalimin e tërësishtëm të dhunës me bazë gjinore, si dhe angazhimin e tyre politik ndaj parimeve dhe vlerave të përfshira në këtë konventë. Konventa u miratua në Stamboll më 7 prill 2011. ●



Njohja e grupit teknik të të rinjve

“Zvirina - Fruit” me teknologjitë e reja në procesin e para dhe pas vjeljes në mollë

Përgatitur nga Nikolin Karapanci

Përmirësimi i teknologjive të kultivimit për rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit, rritja e ndërgjegjësimit të fermerëve drejt arritjes së standardeve të Bashkimit Evropian dhe sidomos përfshirja dhe nxitja e të rinjve për të punuar në fermë janë disa nga komponentët kryesorë të projektit “Mbështetje për rritjen e kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rural” të cilin AgriNet Albania është duke e implementuar me mbështetjen e We Effect, Suedi, në rajonet Korçë, Elbasan dhe Dibër.

Në këtë drejtim u zhvillua një trajnim dhe demonstrim me anëtarët e Grupit teknik të të rinjve “Zvirina - Fruit”, grup i cili zhvillon aktivitetin në Zvirinë një nga fshatrat më me përvojë në drejtim të kultivimit të mollës në rajonin e Korçës.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimit dhe demonstrimi ishte njohja e grupit të të rinjve me teknologjitë më të reja në drejtim të procesit të para dhe pas

vjeljes së frutave të mollës duke përmbytur njëkohësisht kërkesat dhe standardet e Komunitetit Evropian.

Grupit të përbërë prej 15 fermerësh të rinj iu prezantuan një sërë pikash për aplikimin dhe funksionimin e teknologjive e reja në drejtim të procesit para dhe pas vjeljes së mollës duke filluar nga:

- Parapërgatitjen e të gjitha pajisjeve dhe mjeteve për vjelje;
- Përcaktimi i periudhës më optimale për vjeljen e mollës;
 - Matja e fortësisë së frutës;
 - Matja e sasisë së lëndës së thatë të tretshme;
 - Testi i amidonit me tretësirë jodi.
- Procesi i vjeljes së mollës;
- Hapat teknologjikë që merren pas vjeljes për rritjen e cilësisë së frutave në ruajtje.

Nën asistimin e specialistëve u realizuan dhe disa demonstrime për mënyrën e matjes së fortësisë së frutës së mollës me anë të penetrometrit, matjen e sasisë së lëndës së thatë të tretshme me anë të refraktometrit si dhe aplikimin e testit të amidonit me tretësirë jodi për të parë gjendjen e pjekjes së frutave të mollës në varietete të ndryshme.

Duke shkëmbyer pyetje dhe diskutime të pjesëmarrësit në aktivitetet u krijuan përshtypje pozitive mbi domosdoshmërinë e aplikimit të teknologjive bashkëkohore e cila lehtëson ndjeshëm punën gjatë procesit të para dhe pas vjeljes duke rritur njëkohësisht edhe cilësinë e frutave gjatë ruajtjes. ●



Të kontribojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës së banorëve në zonat rurale të Shqipërisë Veri-Lindore

Në fokus të trajnimeve të mbështetura nga "Agropuka" në kuadër të projektit "Të kontribojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës së banorëve në zonat rurale të Shqipërisë Veri-Lindore, Mbështetur nga We Effect, Suedi" kanë qenë trajnime dhe ditë demonstrimi të zhvilluara nga grupet e grave si dhe fermerë dhe prodhues të tjerë lokal.

Grupi i grave Gjegjan ka zhvilluar trajnime me pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit të grave Gjegjan, grave dhe vajzave të njësisë administrative të tjera Gjegjan. Trajnimet janë zhvilluar pranë qendrës së trajnimit në Gjegjan nën drejtimin e këshillueses dhe drejtueses së grupit Zj. Marije Frroku. Temat e trajnimeve lidhen me prodhimet dhe punët e stinës, si më poshtë:

1. Përpunimi i frutave si reçel, komposto dhe lëngje frutash, likere, etj.
2. Tharja e frutave si mollë, hurmë, kumbull etj.
3. Shërbimeve e stinës për bimën e aronisë.
4. Mënyra e ambalazhimit të produkteve të përpunuara dhe të thata.

Edhe Grupi i grave Qelëz ka zhvilluar disa ditë demonstrimi dhe trajnime gjatë muajit shtator nga ku mund të përmendim:

1. Grumbullimi dhe mënyra e vjeljes së bimëve aromatike dhe frutave të pyllit



2. Teknikat e përpunimit të fruta-perimeve në kushte të familjes.
3. Teknologjia e menaxhimit të mbetjeve në fshat me fokus mbrojtjen e ambjentit.
4. Teknologjia e tharjes së fruta-perimeve dhe mënyrat e ruajtjes së tyre.
5. Mënyra e ambalazhimit të produkteve të përpunuara dhe të thata.

Gjithashtu, janë zhvilluar katër trajnime nga Grupi i grave Iballe dhe grupi i grave Kryezi në temat si më poshtë:

1. Grumbullimi dhe vjelja e frutave të

pyllit si boronica, luleshtrydhja dhe kërpudha, etj.

2. Përpunim i frutave të pyllit si reçel, boronicë, komposto etj.
3. Teknologjia e shërbimeve për kulturën e aronisë gjatë kësaj periudhe.
4. Teknologjia e tharjes së frutave të pyllit dhe mënyrat e ruajtjes së tyre.
5. Përpunimi i perimeve, përgatitja e zahireve të ndryshme.
6. Mënyra e ambalazhimit të frutave të pyllit.





Panairi Puka AgroFest 2022

Me datë 24 shtator shoqata "Agropuka", me mbështetjen financiare të We Effect, në kuadër të projektit "Të kontribuojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës së banorëve në zonat rurale të Shqipërisë Veri-Lindore" dhe në bashkëpunim me Bashkinë Pukë zhvilloi panairin e produkteve bujqësore, blegtorale, artizanatit dhe produkte të tjera të prodhuesve të "Agropukës", Puka AgroFest 2022.



Panairi u përshëndet dhe u vizitua nga Kryetari i Bashkisë Pukë Z. Gjon Gjonaj, prefektja e Qarkut Shkodër Majlinda Angoni, koordinatori i RTM Albania, Z. Alberto Sartori dhe Kryetari i Shoqatës së restoranteve turistike dhe bujtinave të Shqipërisë Z. Kujtim Dervishi, ku ndër të tjera u vlerësua kontributi i Shoqatës "Agropuka" dhe donatorëve në mbështetje të zhvillimit rural në Pukë dhe më gjerë.

Në këtë panair ekspozuan produktet e tyre mbi 90 prodhues vendas dhe nga bashki të tjera si Mirdita, Kukes, Shkodër etj. si dhe nga organizata,



projekte dhe institucione financiare lokale.

Panairi u vizitua nga qindra vizitorë të bashkive Pukë dhe Fushë-Arrëz, si dhe nga një numër i madh turistësh vendas dhe të huaj.

Kuvendi i përgjithshëm i FNF-së



Bashkëpunimi midis fermerëve dhe institucioneve është i rëndësishëm në këtë periudhë nëse duam që të përballemi bashkërisht me sfidat që po na ndodhin, konkretisht me rritjen e çmimeve të cilat e rritën çmimin e prodhimit, blerjes dhe ballafaqimint me ndryshimet klimatike. Ky është mesazhi kryesor i dhënë sot në Kuvendin e përgjithshëm të Federatës Nacionale të Fermerëve.

Në pjesa ceremoniale të Kuvendit mbajtën fjalim Nikica Bačkovski, drejtor i Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Goce Georgievski, shef i Njesisë për zhvillim rural në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave, Vasko Haxhievski nga Zyra rajonale e We Effect for Europe, si dhe u prezantuan aktivitetet dhe rezultatet e FSHF-së, ku Vaska Mojsovska, kryetare e FNF-së, Memet Sinani, anëtar i Bordit të FNF-së, Frosina Gjorgievska, anëtare



e Bordit të FNF-së dhe Stevan Orozovic, drejtori ekzekutiv i FNF-së. Moderatorja e ngjarjes Biljana Petrovska – Mitrevska, menaxhere e projektit.

Në suazat e pjesës së punës, u miratuan raporti narrativ dhe financiar i FNF-së për vitin 2021, programi dhe buxheti i FNF-së për vitin 2022, modeli i biznesit të FNF-së dhe u arrit konkluzioni që FNF-ja nëpërmjet zyrës ekzekutive dhe Bordit drejtues të FNF-së duhet të vazhdojë të llobojë dhe përfaqësojë dhe të avokojë në mënyrë specifike për të

theksuar kërkesën për përdorim më të madh të tokës bujqësore nëpërmjet krijimit të një Fondi për menaxhimin e tokës bujqësore shtetërore. Drejtori ekzekutiv i FNF-së, Stevan Orozovic, prezantoi aktivitetet e kryera nga FNF-ja dhe tha se theksi i veçantë gjatë kësaj periudhe i është kushtuar realizimit të ndërhyrjeve me fermerët në drejtim të zgjidhjes së marrëdhënieve të çrregulluara në treg. Këto ndërhyrje mbështeten nga Organizata suedeze e zhvillimit We Effect dhe Agjencia suedeze për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar - Sida. Gjithashtu, theksoi se një theks i veçantë në organizatë është lobimi dhe avokimi, pasi FNF-ja është anëtare e grupit më të madh lobues në Evropë, Kopa-Kozheka. Nëpërmjet mbështetjes nga GIZ-i u krijua platforma e parë e shitjes www.efarm.mk, FNF-ja i kushton vëmendje të veçantë përforcimit të grave fermere dhe promovon qasjen e sipërmarrjes femërore, në mënyrë të tillë që FNF-ja së bashku me Shoqatën e grave afariste, Unionin i dhomave të tregtisë dhe MIR e formuan Platformën për sipërmarrjen e grave. Orozovic theksoi se një nga rezultatet e FNF-së është se fakti që e theksoi problemin e personave me aftësi të kufizuara në zonat rurale dhe ofroi mbështetje për 30 familje në kuadër të projektit "From Disability to FoodAbility" të mbështetur nga We Effect. Kryesues e pjesës së punës është Svetlana Trifunovska. ●



Dhënia solemne e certifikatave për 37 bletarë të rinj



Më 7 gusht 2022, në Eurohotel Gradçe – Koçani u mbajt dhënia solemne e certifikatave për 37 bletarë të rinj për përfundimin e trajnimit të dytë të certifikuar “Bletar për bletari themelore në mënyrë të qëndrueshme”,



të zbatuar nga Meden Istok dhe e mbështetur nga Federata nacionale e fermerëve – FNF, We effect dhe Sida, si pjesë e projektit “Zhvillim organizativ i FNF-së dhe lidhje të përmirësuar me tregun për bujqit e vegjël dhe prodhuesit nga rajonet rurale me qëllim të zmadhimit të të hyrave”.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësi kishin mundësi të mësojnë të kultivojnë bletë në koshet e tyre me përdorim të metodave bioteknike dhe të bëhen bletarë të certifikuar të bletarisë së qëndrueshme me këto kompetenca:

Ky trajnim katërmujor përfshinte ligjërata teorike të mbajtura në qendrën edukative, kurse pjesën praktike bletarë e kanë ndjekur në bletoret ku u janë prezantuar të gjitha proceset e bletarisë së qëndrueshme.

Në përfundimin ceremonial të trajnimit, përveç dhënies solemne të certifikatave u mbajt dhe garë për degustim për shijen më të mirë të mjaltit.

Mundësi që të marrin pjesë në këtë garë kishin edhe anëtarët e Shoqatës si të pranishëm në këtë eveniment.

Në këtë ceremoni, ligjëruesit Vanço Kirovski dhe Marjan Arsov u dëshiruan suksese të mëtejshme të mjalta nxënësve të vet dhe u ofruan anëtarësim në Shoqërinë JGPBR Meden Istok, e cila numëron mbi 30 anëtarë. Fjalim përsëritës mbajtën edhe drejtori i Federatës nacionale të Maqedonisë – Stevan Orozoviq, si dhe këshilltari programues o Programit për ruajtjen e natyrës – Katerina Ivanovska duke u uruar suksës pjesëmarrësve të sivjetshëm në këtë trajnim.

FNF-ja Analizë shumëdimensionale për varfërinë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Varfëria është përditshmëri në jetën e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kështu që kategoritë më vulnerabile nuk i njohin trajtimin e pabarabartë, qasjen e pabarabartë në shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore, infrastrukturën e keqe, shkeljen e të drejtave të njeriut si dimensione të varfërisë, por i shohin si përditshmëri në jetën e tyre.

Romët, gratë dhe të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e bashkësisë LGBTI janë tradicionalisht midis

grupeve më të lëndueshme. Përveç armiqësisë dhe sulmit fizik, ata janë në rrezik shumë të lartë nga varfëria. Grupet vulnerabile, sidomos në mjediset rurale, janë të rinjtë dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara, të sëmurët, pleqtë, si dhe familjet me një prind.

Kur bëhet krahasimi midis mjediseve rurale dhe urbane, fshatrat janë më të prekurit nga varfëria, veçanërisht në fushën e infrastrukturës, aksesit të kufizuar në shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore, jeta sociale nuk

ekziston, çmimet e ulëta të blerjes së produkteve bujqësore, të ardhurat e ulëta dhe ndryshimet klimatike i shtojnë në varfëri më të madhe personat që jetojnë në zonat rurale.



Këto janë disa nga përfundimet themelore të Analizës shumëdimensionale të varfërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut të përgatitur nga Federata Nacionale e Fermerëve, në suazat e projektit “Zhvillimi organizativ i FNF-së dhe lidhjet e përmirësuar me tregun për fermerët e vegjël dhe prodhuesit e vegjël të ushqimit nga zonat rurale, me qëllim rritjen e të ardhurave të tyre” që mbështetet nga Organizata suedeze e zhvillimit We Effect dhe Agjencia suedeze për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar – Sida. Autorë të analizës janë prof. dr. Emel Tuna, prof. dr. Ana Simonovska dhe Mr. Biljana Petrovska-Mitrevska.





FNF



FEDERATA NACIONALE E FERMERËVE

Federata Nacionale e Fermerëve e zgjeroi spektrin e vet të veprimit. Kjo do të thotë që përveç bujqve, shoqatave bujqësore, kooperativave bujqësore, organizata mandej do të punojë në përforcimin dhe mbështetjen e kategorive të lëndueshme në mjediset rurale, mbështetje më të madhe të të rinjve dhe grave si dhe për përfshirje të tyre të drejtpërdrejtë në zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet vendimmarrjes dhe veprimtarisë aktive. Përveç bujqve, një nga fokuset kryesore të organizatës është edhe zhvillimi rural përkatësisht tejkalimi i problemeve dhe sfida me të cilat ballafaqohet popullata rurale siç janë varfëria dhe qasja e kufizuar e popullatës rurale në shërbimet shëndetësore, edukim, informim, drejtësi dhe fuqi në vendimmarrje. Edhe mandej shtylla kryesore e veprimtarisë është lobimi në drejtim të përcaktimit të problemeve nga fusha që me punë e analizë të përbashkët do të prezantohen para institucioneve kompetente

që të gjendet zgjidhje e përbashkët, e cila do të jetë në interes të bujqve dhe të mirëqenies të të gjithë shtetit tonë. Fokusi i Organizatës Nacionale të Fermerëve, edhe mandej do të funksionojë nën sloganin "Së bashku drejt suksesit" dhe nën logon e cila e simbolizon mundin dhe prodhimtarinë e bujqve tanë, është zgjidhja e problemeve më të mëdha, siç është plasmani dhe prodhimtaria cilësore. Misioni i organizatës së ribrenduar është: FERMER I ORGANIZUAR - LIDER NË ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE RAJONAL NË RM. Vizionin që ne synojmë ta arrijmë është: BUJQËSI FITIMPRURËSE - FSHAT I QËNDRUESHËM.

AGROPUKA



AGROPUKA është një shoqatë e prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë të rrethit të Pukës (Shqipëria e Veriut). Ajo është krijuar në 2001 me mbështetjen e Bashkëpunimit për Zhvillim të Zvicrës (SDC). Që nga ajo kohë, shoqata ka rritur anëtarësinë e saj dhe ka zgjeruar aktivitetin dhe shërbimet, për të plotësuar nevojat e anëtarëve dhe komunitetit në përgjithësi. Shoqata kontribuon në zhvillimin e integruar rural nëpërmjet inkurajimit dhe promovimit të zhvillimit ekonomik si dhe të iniciativave dhe veprimtarive për të përmirësuar jetesën e anëtarëve të AP dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë mënyrë AP ndikon në reduktimin e varfërisë dhe padrejtesive sociale në zonat rurale.

Nga viti 2011, Agropuka po zbaton projektin "Të kontribuojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës së banorëve në zonat rurale të Shqipërisë Veri-Lindore" që financohet nga We Effect (Suedi). Projekti synon përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimit të demokracisë dhe pjesëmarrjes

lokale. Në dy vitet e ardhshme shoqata do të përqendrohet në tre fusha:

- (1) Përmirësimin e kushteve të jetesës së anëtarëve të AP dhe të komuniteteve në zonat ku punon AP nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit, marketingut, dhe modeleve të kooperimit;
- (2) Promovimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; dhe (3) Promovimin e demokracisë lokale dhe përfshirjes sociale të komuniteteve rurale në vendim-marrjen lokale.

Grupet e synuara të shoqatës AGROPUKA përfshijnë: Anëtarët; Prodhuesit vendorë të bujqësisë, blegtorisë dhe përpunimit; Grupet e interesit të grave; Të rinjtë dhe grupet rinore.

Për këtë Agropuka do të rrisë qëndrueshmërinë, përgjegjësinë dhe kapacitetin organizativ të saj.

FONDACIONI AGRINET ALBANIA

AgriNET është organizatë shqiptare apolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse e regjistruar në shkurt të vitit 2005 me seli në rajonin e Korçës. Tani ajo është rrjetë e 15 organizatave bujqësore nga tre rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj organizate është pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në proceset sociale, ekonomike dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive të cilat jetojnë në rajone rurale në partneritet me sektorët ruralë të marginalizuar, bashkësitë e tyre dhe palët e ndryshme të prekura. AgriNet e realizon misionin e vet nëpërmjet implementimeve të ndryshme në projektin në fushën e zhvillimit rural financuar nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare, si edhe nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësive, pushtetit lokal dhe organizatave të tjera joqeveritare në fushën e zhvillimit rural të bashkësisë. AgriNet siguron shërbime të

zgjeruara në pjesën më të madhe të rasteve për grupe formale dhe joformale të prodhuesve bujqësorë. Lloji kryesor i grupeve bujqë-

sore për shërbime të zgjeruara janë: grupet e prodhuesve të cilët zbatojnë Praktika bujqësore të mira (Good Agricultural Practices - GAP), zbatim i trajnimeve të moderuara nga ekspertë në nivel nacional, organizim i shkëmbimit të përvojave për prodhuesit bujqësorë inovativë, organizim i parcelave demonstruese për testim dhe zbatim të teknologjive inovuese dhe zhvillim të publikimeve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e teknologjive inovuese dhe GAP.

